



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 57 regjistër (JR)
Datë 11.10.2021

Nr. 62 i vendimit
Datë 05.12.2024

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

Natasha Mulaj	Kryesuese
Sokol Çomo	Relator
Ina Rama	Anëtare
Albana Shtylla	Anëtare
Mimoza Tasi	Anëtare

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, më datë 05.12.2024, ditën e enjte, ora 10:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Ferdinando Buatier De Mangeot, me Sekretar Gjyqësor Kevin Kovaçica, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit nr. 57/2021 (JR), datë 11.10.2021, që i përket:

ANKUESE: Subjekti i rivlerësimit, znj. Mirela Iliopullo, gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit nr. 420, datë 13.07.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Mirela Iliopullo.

BAZA LIGJORE: Neni F i Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenet 42 dhe 179/b, pika 5 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 1, 2, 62, 63 dhe 66, pika 1, germa “b” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; neni 46 i ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e

mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar; Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë.

Trupi gjykes i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, në datën 05.12.2024, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), shqyrtoi shkaqet e ankimit dhe pretendimet e ngritura nga subjekti i rivlerësimit, në ankim dhe në parashtrime, me anë të të cilave kërkoi ndryshimin e vendimit nr. 420, datë 13.07.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, dëgjoi gjyqtarin relator të çështjes Sokol Çomo, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit, znj. Mirela Iliopullo (në vijim “subjekti i rivlerësimit”), për shkak të ushtrimit të funksionit të gjyqtarës në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar, *ex officio*, në zbatim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës dhe nenit 3, pika 16 e ligjit nr. 84/2016.
2. Subjekti i rivlerësimit ka plotësuar dhe dërguar pranë Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”) brenda afatit ligjor, në përputhje me nenin 31, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, deklaratën e pasurisë.
3. Inspektori i Përgjithshëm i ILDKPKI-së, pasi kreu procedurën e kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, në zbatim të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, dërgoi pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar, duke konstatuar se:
 - (i) deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;
 - (ii) ka mungesë të dokumentacionit ligjor për të justifikuar pasuritë;
 - (iii) nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
 - (iv) nuk ka kryer deklarim të rremë;
 - (v) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

4. Komisioni, pasi kreu procesin e rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit, znj. Mirela Iliopullo, bazuar vetëm në kriterin e vlerësimit të pasurisë, në bazë të shkronjës “c” të pikës 1 të nenit 58 dhe të pikave 3 dhe 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, me vendimin nr. 420, datë

13.07.2021, vendosi: *Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Mirela Iliopullo, gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastër. [...]*

5. Komisioni e ka bazuar këtë vendim në konkluzionet se subjekti i rivlerësimit: *(i) ka pasur mungesë të theksuar të burimeve financiare të ligjshme sipas parashikimeve të nenit D të Aneksit të Kushtetutës për të kryer të gjitha investimet dhe njëkohësisht për të përballuar shpenzimet apo për të realizuar kursimet e deklaruara; (ii) ka kryer në mënyrë të përsëritur deklarime të pamjaftueshme dhe ka fshehur pasurinë; (iii) subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut në sistemin e drejtësisë në Shqipëri. Për rrjedhojë, subjekti nuk arriti nivel të besueshëm në vlerësimin e deklarimit të pasurisë dhe duhet të aplikohet pika 5 e nenit D të Aneksit të Kushtetutës, si dhe pikat 3 dhe 5, të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.*

III. Ankimi i subjektit të rivlerësimit

6. Subjekti i rivlerësimit i është drejtuar Kolegjit të Posaçëm të Apelimit (në vijim “Kolegji”) me ankim kundër vendimit nr. 420, datë 13.07.2021, për shkaqe me natyrë procedurale dhe materiale, lidhur me situatën faktike dhe zbatimin e ligjit.
7. Bazuar në nenin 66, pika 1, germa “b” e ligjit nr. 84/2016, si dhe në nenin 51 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, subjekti i rivlerësimit kërkoi nga Kolegji:

- Prishjen e vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 420, datë 13.07.2021, dhe dërgimin e çështjes Komisionit/KLGj-së, për të vazhduar më tej procedurën e rivlerësimit për kriteret e mbetura pa u vlerësuar. Ose:

- Gjykimin e çështjes në seancë publike; konstatimin e shkeljeve të të drejtave kushtetuese, si dhe ato të parashikuara nga KEDNj-ja ndaj subjektit të rivlerësimit, znj. Mirela Iliopullo; çeljen e shqyrtimit gjyqësor, administrimin e provave të reja dhe hetimin e dy kritereve të tjera; riçeljen dhe rivlerësimin e kriterit të pasurisë; ndryshimin e vendimit nr. 420, datë 13.07.2021, të Komisionit, duke vendosur konfirmimin në detyrë të znj. Mirela Iliopullo, gjyqtare në Gjykatën e Shkallës së Parë Gjirokastër.

8. Subjekti i rivlerësimit, duke pretenduar pamundësinë për paraqitjen në Komision të dokumenteve provuese për shkaqe objektive, ankimin e saj e shoqëroi me disa akte shkresore, të cilat kërkoi të merren në cilësinë e provave të reja në përputhje me nenet 45, pikat 1 dhe 2, 49 dhe 52, pika 1 e ligjit nr. 84/2016.
9. Në mbështetje të shkaqeve të ankimit, subjekti i rivlerësimit paraqiti në Kolegji parashtrime me shkrim në datat 26.09.2024, 21.10.2024 dhe 02.12.2024, bashkëlidhur të cilave depozitoi edhe disa akte shkresore të cilat kërkoi të merren si prova të reja në gjykim.

IV. Shqyrtimi i ankimit në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit

A. Mbi aspektet procedurale të gjykimit

a) Juridiksioni i Kolegjit

10. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji ka juridiksion (*ratione materiae*) për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Komisionit, lidhur me rivlerësimin e subjekteve, të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, përveç rasteve të vendimeve të dhëna, sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, për sa kohë ka në objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit, i cili ka vendosur për rivlerësimin e subjektit, znj. Mirela Iliopullo, duke vendosur shkarkimin e saj nga detyra, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

b) Legjitimimi i ankuesit

11. Ankuesja legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të nenit F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe të nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, dhe *ratione temporis*, pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh nga data e njoftimit të vendimit të arsyetuar, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

c) Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit

12. Në përputhje me nenin 65, pika 1¹ e ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i ankimit në rastin kur vendimi i Komisionit ankimohet nga subjekti i rivlerësimit, si rregull, kryhet mbi bazë dokumentesh në dhomë këshillimi, përveç rasteve kur trupi gjykues në vijim vendos se plotësohen kriteret e përcaktuara në nenin 51 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 49/2012”, i ndryshuar), për shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore publike me praninë e palëve. Për rrjedhojë, edhe çështja objekt gjykimi, e cila lidhet me shqyrtimin e vendimit të Komisionit nr. 420, datë 13.07.2021, bazuar në shkaqet e ngritura në ankimin e subjektit të rivlerësimit, u mor fillimisht në shqyrtim nga Kolegji në dhomë këshillimi.

13. Trupi gjykues, pasi mori në shqyrtim kërkesën e subjektit të rivlerësimit për çeljen e hetimit gjyqësor dhe marrjen e provave të reja², konstatoi se në kuadër të parashikimeve të nenit 47 të

¹Procesi gjyqësor në Kolegjin kryhet në përputhje me rregullat e parashikuara në nenet 47, 48 pika 1, 49, 51 dhe 55 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

²Aktet bashkëlidhur ankimit për të cilat subjekti kërkoi marrjen si prova të reja në gjykim: (i) katër mandate transfertash bankare të kryera pranë Raiffeisen Bank, dy prej të cilave rezultojnë në të njëjtën datë 22.12.2010 dhe në shumën 7.000 USD (pra, për të njëjtën transfertë prej 7.000 USD), e cila rezulton të jetë kryer nga R. B. vjehri i

ligjit nr. 49/2012, sipas të cilave subjekti i rivlerësimit nuk mund të paraqesë në ankim fakte të reja apo të kërkojë prova të reja, përveçse kur provon se pa fajin e saj nuk ka mundur t'i paraqesë këto fakte ose të kërkojë marrjen e këtyre provave gjatë shqyrtimit në Komision, vlerësuar në harmoni me nenin 51, pika 1, shkronja "a" e të njëjtit ligj. Gjithashtu, në vendimmarrjen e trupit gjykues mbi kërkesat e subjektit të rivlerësimit për marrjen e provave të reja, u mbajtën në konsideratë edhe parashikimet e nenit 49, pika 6 e ligjit nr. 84/2016. Në kuadër të analizës së mësipërme, trupi gjykues çmoi se aktet e dorëzuara së bashku me ankimin, nuk përmbushën kriteret e pranueshmërisë si prova të reja në proces, pasi subjekti nuk provoi pamundësinë objektive të paraqitjes së tyre në Komision dhe për rrjedhojë, nuk u pranuan në cilësinë e provës së re nga trupi gjykues. Gjithashtu, subjekti ka paraqitur së bashku me parashtrimet me shkrim edhe disa akte shkresore³ për të cilat ka kërkuar të merren si prova të reja në gjykimin e çështjes në Kolegj. Trupi gjykues vlerëson se, bazuar në nenin 49, pika 2 e ligjit nr. 49/2012, palët kanë të drejtë të paraqesin deri 5 ditë para seancës së çështjes, parashtrime me shkrim lidhur me shkaqet e ngritura në ankim, por kjo dispozitë nuk i lejon palët të ngrenë shkaqe të reja ankimi dhe as të paraqesin prova të reja të cilat nuk i kanë paraqitur së bashku me ankimin dhe, si rrjedhojë, kërkesa e subjektit të rivlerësimit për marrjen e këtyre provave, u refuzua.

14. Në vijim, trupi gjykues shqyrtoi kërkesën e subjektit të rivlerësimit për kalimin e çështjes për gjykim në seancë gjyqësore publike me praninë e subjektit të rivlerësimit, duke kontrolluar zhvillimin e procesit të rivlerësimit në Komision nëpërmjet shqyrtimit të dokumentacionit të fashikullit të Komisionit. Nga ky kontroll, nuk u konstatuan shkelje procedurale, të tilla që të kërkonin korrigjimin e tyre sipas parashikimeve të nenit 51, pika 1 e ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar, duke kaluar gjykimin e çështjes në seancë gjyqësore publike në prani të palëve dhe se lidhur me këtë çështje, mund të arrihej në vendimmarrje nga shqyrtimi i ankimit mbi bazën e dokumenteve të administruara në fashikullin e Komisionit. Për rrjedhojë, në përfundim të analizës së mësipërme,

vajzës së subjektit, me përshkrimin "Payment for school"(pagesë për shkollën), mandati i tretë, transfertë e datës 11.06.2013 në shumën 1.000 USD me përshkrimin "pagesë për qera" e kryer nga shoqëria "{***}" ShPK me përfitues D. B. dhe mandati i katërt, transfertë e datës 28.06.2013 në shumën 1.600 USD me përshkrimin "pagesë qeraje" e kryer nga shoqëria "{***}" ShPK me përfitues D. B.; (ii) lëvizjet e llogarisë bankare të shoqërisë "{***}" ShPK në monedhën USD në Raiffeisen Bank për periudhën 02.10.2009 -27.01.2015.

³Me parashtrimet e datës 26.09.2024, subjekti ka paraqitur: shkresë nr. {***} prot., datë 05.01.2022 (shkresë e gjeneruar nga sistemi elektronik me nënshkrim të datës 2023.08.02) e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Drejtoria Vendore Sarandë, shkresë nr. {***} prot., datë 10.11.2022 shkresë e gjeneruar nga sistemi elektronik i Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Drejtoria Vendore Sarandë, dokument nga Drejtoria e Policisë Janinë datë 25.06.2024 me lëndë "Ofrim informacioni tek shtetasi J. K., shkresë e gjeneruar nga sistemi elektronik me nënshkrim të datës 2024.09.11 e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, kopje e librezës së Furnizuesit të Shërbimit Universal (FShU) për kontratën nr. {***} të z. J. I., e cila pasqyron pagesat për vitin 2024, vendimi nr. 32, datë 24.07.2023 i Kolegjit dhe vendimi nr. 479, datë 03.12.2021 i Komisionit, faqe e printuar nga portali elektronik Bold News, lajm i datës 10.04.2022 me titull "Ka futur burra e gra, e ka kopsitur mirë", si u falsifikua shorti i KPK-së për të favorizuar peshkaqenët e drejtësisë", dhe foto e procesverbalit të mbledhjes së anëtarëve të Komisionit, përgjigje e nëpunëses kompetente znj. E. P., nga Drejtoria e Çështjeve Arsimore dhe Kulturore në Ministrinë e Jashtme të Greqisë, "Bursa e M. K."

trupit gjykues vendosi të vijojë shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, mbi bazë dokumentesh, sipas parashikimeve të nenit 49 të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar.

B. Shkaqet e ankimit që lidhen me aspekte procedurale të procesit të rivlerësimit të kryer nga Komisioni dhe vlerësimi i trupit gjykues

15. Shkaqet e ankimit lidhur me aspektet procedurale të procesit të zhvilluar në Komision, parashtrihen në mënyrë të përmbledhur si më poshtë.

15.1. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se vendimi i Komisionit është marrë mbi bazën e një hetimi dhe vlerësimi administrativ të paplotë, pa u bazuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, apo në ligjin nr. 84/2016. Konkluzionet e Komisionit janë nxjerrë në shkelje të parimeve themelore procedurale, pasi ndaj saj është zhvilluar një proces i parregullt ligjor, në kuptim të neneve 42 dhe 179/b, pika 2 e Kushtetutës, nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në vijim “KEDNJ”), nenit 4, pikat 5 dhe 6, të nenit 52, pika 1 e ligjit nr. 84/2016.

15.2. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së, duke iu referuar vendimit të GjEDNJ-së në çështjen *Volkov kundër Ukrainës*, lidhur me analizën e katër kritereve që duhet të merren në analizë për të përcaktuar nëse një organ që jep masa disiplinore ndaj gjyqtarëve, është një organ i pavarur dhe i paanshëm. Subjekti i rivlerësimit evidenton se: asnjë nga të 12 anëtarët e Komisionit nuk ka ardhur nga gjyqësori në momentin e emërimit; (ii) ata janë zgjedhur nga një komitet specifik (*ad hoc*) parlamentar dhe caktuar nga Parlamenti, me një procedurë e cila ka shumë defekte dhe disa nga anëtarët që shqyrtuan çështjen e saj nuk plotësonin kërkesat e përzgjedhjes të përcaktuara me ligjin nr. 84/2016; (iii) i njëjti trup gjykues i Komisionit ka kryer hetimin administrativ dhe njëkohësisht edhe gjykimin e çështjes së saj; (iv) anëtarët e institucioneve të rivlerësimit kalimtar kanë mandat të kufizuar i cili i bën ata të prekshëm, duke ndikuar e minuar pavarësinë e tyre dhe se ata nuk kanë garanci për pandryshueshmërinë e tyre.

15.3. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se një shkak tjetër që ka ndikuar në anshmërinë e trupit gjykues të Komisionit, është fakti se ankuesja është përfshirë në procedurën e rivlerësimit pa short, në bazë të një liste të propozuar nga Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit, dhe se nuk janë të njohura për atë kriteret që kanë udhëhequr ONM-në për përpilimin e kësaj liste. Ndërkohë ligji nuk i jep të drejtë Komisionit të miratojë rregulla për radhën e përparësisë, të ndryshme nga ato të miratuara në ligj. Sipas subjektit, për shkak të përfshirjes në këtë listë, në të gjithë procedurën e ndjekur ndaj subjektit të rivlerësimit, znj. Mirela Iliopullo, ka elemente të theksuara të paragjykimimit dhe vendimi objekt ankimi ka qenë i paracaktuar.

15.4. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së, bazuar edhe në pretendimin se i është mohuar e drejta për t’u mbrojtur dhe dëgjuar në mënyrë efektive, si dhe dëgjuar drejtësisht, në përputhje me parimin e kontradiktoritetit dhe barazisë së armëve. Komisioni ka nxjerrë konkluzione që përbëjnë shkak shkarkimi pa ia njoftuar paraprakisht subjektit dhe pa i kaluar barrën e provës, duke mos i dhënë asnjë mundësi për t’u mbrojtur dhe se në asnjë fazë të

procesit nuk ka mundur të identifikojë personin që ka hartuar analizën financiare, i cili nuk mban asnjë përgjegjësi ligjore, nuk dihet se çfarë njohurish të posaçme ka apo nëse është në kushtet e konfliktit të interesit me ankuesen. Gjithashtu, subjekti pretendon se analiza financiare e përgatitur nga subjekti nëpërmjet një audituesi të licencuar, nuk iu nënshtrua debatit dhe nuk u analizua nga Komisioni.

16. Në kuadër të shqyrtimit të këtij shkaku ankimi, trupi gjykues, së pari, mori në shqyrtim pretendimin e subjektit të rivlerësimit se i është cenuar e drejta për proces të rregullt ligjor në kuptim të nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në vijim “KEDNj”), për shkak të mosgjyqimit nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme pasi nuk janë respektuar kriteret e përcaktuara nga jurisprudenca e GjEDNj-së⁴, në drejtim të garantimit të pavarësisë dhe paanësisë së organit që ka dhënë masën disiplinore lidhur me: (i) përfaqësimin thelbësor të gjyqtarëve në organin disiplinor; (ii) mënyrën e zgjedhjes së anëtarëve të Komisionit dhe ekzistencën e garancive ndaj presioneve të jashtme; (iii) faktin e dublimit të funksioneve hetimore dhe gjyqësore; si dhe (iv) kohëzgjatjen e mandatit të anëtarëve të Komisionit.

16.1. Trupi gjykues vlerëson se është krijuar tashmë një jurisprudencë e konsoliduar e Kolegjit, sipas së cilës këto pretendime janë vlerësuar të pabazuara në ligj, qëndrim të cilin Kolegji e ka bazuar në faktin se veprimtaria e trupës gjyqësore të Komisionit, kompetencat në kryerjen e procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe mënyra e ushtrimit të tyre janë parashikuar shprehimisht në Kushtetutë dhe në ligjin nr. 84/2016. Me vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 2, datë 18.01.2017, është konfirmuar kushtetutshmëria e ligjit nr. 84/2016 dhe GjEDNj-ja, me vendimin për çështjen *Xhoxhaj kundër Shqipërisë*, ka vlerësuar se kuadri ligjor i procesit të rivlerësimit kalimtar garanton respektimin e nenit 6 të KEDNj-së lidhur me parimin e gjykatës së pavarur dhe të paanshme.

16.2. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se Kolegji ka kompetencë dhe duhet të marrë në shqyrtim kushtet e zgjedhshmërisë të anëtarëve të Komisionit dhe Kolegjit për shkak se është dhomë e Gjykatës Kushtetuese dhe duhet t’u japë zgjidhje në themel pretendimeve të saj në lidhje me mospërbushjen e kriterëve të emërimit nga anëtarët e organeve të rivlerësimit, trupi gjykues vlerëson se, në referim të dispozitave kushtetuese të cilat përcaktojnë gamën e kompetencave të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, nuk përfshihet vlerësimi i plotësisë së kushteve dhe kriterëve të zgjedhjes në detyrë të komisionerëve të Komisionit apo të anëtarëve të tjerë të institucioneve të procesit të rivlerësimit kalimtar. Për rrjedhojë, ky pretendim i subjektit vlerësohet i pabazuar në ligj. Një qëndrim i tillë është konfirmuar edhe në vendimmarrje të mëparshme të Kolegjit për pretendime të së njëjtës natyrë⁵. Trupi gjykues çmon të evidentojë gjithashtu edhe faktin se subjekti i rivlerësimit nuk ka ngritur asnjë pretendim tjetër në drejtim të ekzistencës së fakteve/situatave konkrete, ekzistenca e të cilave, referuar parashikimeve të nenit 27 të ligjit nr. 84/2016, do të përbënte pengesë ligjore për pjesëmarrjen në trupin gjykues të anëtarëve të

⁴ Referuar çështjes *Voklov kundër Ukrainës*.

⁵ Shih vendimin e Kolegjit nr. 7/2020 (JR), 6/2021 (JR).

Komisionit që ka rivlerësuar subjektin e rivlerësimit, znj. Mirela Iliopullo. Subjekti gjithashtu nuk ka pretenduar asnjë fakt apo rrethanë e cila dëshmon për shprehje njëanshmërie të këtyre anëtarëve të trupit gjykues gjatë procesit të saj. Në lidhje me anëtarët e institucioneve të rivlerësimit, Kolegji ka kompetencë vetëm për të hetuar dhe gjykuar shkeljet disiplinore të tyre, të kryera gjatë ushtrimit të detyrës dhe për të cilat mund të vihet në lëvizje vetëm sipas parashikimeve të nenit 17, pika 1 e ligjit nr. 84/2016.

16.3. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se në anshmërinë e Komisionit ka ndikuar përfshirja pa short e subjektit në procedurën e rivlerësimit në bazë të një liste të propozuar nga ONM-ja, trupi gjykues vëren se, në vendimin nr. {***} të datës 19.11.2019, të trupit gjykues të Komisionit për caktimin e kryesuesit, relatorit dhe deklarin e konfliktit të interesit, trupi gjykues i referohet mbledhjes së Komisionit për hedhjen e shortit të datës 07.11.2019, për subjektet e listës së përparësive për shkak të ligjit dhe jo sipas ndonjë liste të propozuar nga ONM-ja apo ndonjë akti të Komisionit me të cilin janë miratuar rregullat për radhën e përparësisë. Në faqen zyrtare në internet të Komisionit, në momentin e gjykimit të çështjes në Kolegj, rezultoi i publikuar njoftimi për fillimin e procedurave të rivlerësimit për 48 subjekte, sipas shortit të datës 12.11.2019⁶, dhe sipas listës së miratuar me vendimin nr. {***}, datë 07.11.2019, të Komisionit, ku subjekti i rivlerësimit, znj. Mirela Iliopullo, renditet me numër 25⁷. Sa më sipër, nuk konstatohen fakte të cilat të mbështesin pretendimin e ngritur nga subjekti se është përfshirë në procesin e rivlerësimit mbi bazën e kriterëve të panjohura, pa short, apo për shkak se janë favorizuar subjektet e tjera të rivlerësimit.

17. Lidhur me pretendimin e subjektit se, në shkelje të nenit 6 të KEDNj-së, i është mohuar e drejta për t'u mbrojtur dhe dëgjuar në mënyrë efektive si dhe dëgjuar drejtësisht, në përputhje me parimin e kontradiktoritetit dhe barazisë së armëve, trupi gjykues pasi shqyrtoi aktet e fashikullit të çështjes konstaton se Komisioni, me anë të tre pyetësorëve i ka kërkuar shpjegime subjektit për çështje të ndryshme që lidhen me kriterin e vlerësimit të pasurisë, dhe se vetëm pasi subjekti ka dhënë shpjegime lidhur me to, Komisioni ka vijuar me hartimin e raportit të rezultateve paraprake të hetimit administrativ, të cilat ia ka njoftuar subjektit të rivlerësimit si dhe e ka ftuar⁸ atë të marrë kopje elektronike të akteve të fashikullit të hetimit administrativ të krijuar nga Komisioni. Në këtë raport, rezultoi se Komisioni ka pasqyruar të gjitha provat e administruara, shpjegimet e subjektit, duke evidentuar në mënyrë të qartë konstatimet që kanë ndikim në kriterin e vlerësimit të pasurisë dhe vlerësimin paraprak lidhur me to, për të cilat në zbatim të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, i ka

⁶ <https://kpk.al/njoftim-143/11>

⁷ Subjekti i rivlerësimit nuk rezultoi të ketë paraqitur ndonjë pretendim gjatë shqyrtimit nga ana e Komisionit në lidhje me procedurën e shortit apo për përfshirjen e saj në listën e përparësive për shkak të ligjit. Referuar deklaratës të nënshkruar prej subjektit në datë 18.06.2021, evidentohet si vijon: “[...] pasi u njoha me dokumentacionin fizik dhe në formë elektronike (CD) të dosjeve të hetimit administrativ të zhvilluar nga Komisioni, deklaroi se [...] u njoha dhe mora të gjithë dokumentacionin e kërkuar nga ana ime në CD apo në formë shkresore (fotokopje) sipas kërkesës sime. Deklaroj se nuk kam asnjë vërejtje në lidhje me dokumentacionin/materialet e tërhequra pranë Komisionit. Ky dokumentacion është konform me dokumentacionin e dosjeve që m'u vunë në dispozicion [...]”.

⁸ E-mail, datë 16.06.2021, “Njoftim i rezultateve të hetimit”, ku bashkëlidhen rezultatet e hetimit dhe analiza e rezultateve financiare.

kaluar subjektit barrën e provës, të cilat rezultojnë të jenë të njëjtat fakte për të cilat Komisioni, me anë të pyetësorëve, i ka kërkuar më parë shpjegime. Dispozitat e kuadrit ligjor të procesit të rivlerësimit kalimtar nuk parashikojnë detyrimin që Komisioni, në këtë akt procedural të shprehet literalisht lidhur me prezumimin e masës disiplinore, për më tepër, subjektet e rivlerësimit, me formimin e tyre profesional, kanë aftësitë për të vlerësuar peshën e konstatimit në raport me parashikimet e Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, kjo edhe në referim të parashikimeve të nenit 87 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”. Subjekti i rivlerësimit, pasi është njohur me rezultatet e hetimit dhe provat e mbledhura nga Komisioni gjatë hetimit administrativ, ka prapësuar këto rezultate dhe ka paraqitur prova lidhur me pretendimet e parashtruara. Lidhur me zhvillimin e seancës dëgjimore në Komision, trupi gjykues konstaton se ajo ka nisur me shpjegimin e komisionerit relator, i cili ka dhënë një përshkrim të hollësishëm të rezultateve të hetimit lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë dhe në vijim, subjekti ka dhënë shpjegimet e saj, duke ju dhënë mundësia të paraqiste prova lidhur me pretendimet e parashtruara.

18. Lidhur me pretendimin e subjektit se në asnjë fazë të procesit, nuk i është bërë me dije personi që e ka hartuar analizën financiare të kryer në Komision dhe se akti mbi bazën e të cilit prodhohet rezultati financiar është i panjohur, ndërsa Komisioni nuk ka marrë në shqyrtim analizën financiare të kryer nga audituesi ligjor i zgjedhur prej saj, trupi gjykues vlerëson se, bazuar në nenin 22 të ligjit nr. 84/2016, pranë Komisionit dhe Kolegjit funksionon Njësia e Shërbimit Ligjor që ushtron veprimtari këshilluese dhe ndihmëse në procesin vendimmarrës, e cila përbëhet nga këshilltarë ligjorë dhe ekonomikë. Analizat financiare të hartuara nga Njësia e Shërbimit Ligjor i nënshtrohen kontrollit dhe debatit nga subjekti i rivlerësimit, në kuadër të parimit të kontradiktoritetit dhe në çdo rast trupi gjykues vendos sipas bindjes së tij të brendshme. Lidhur me pretendimin për mos administrimin dhe mos analizimin e raportit të audituesit ligjor të zgjedhur nga subjekti, trupi gjykues, referuar procesverbalit të seancës dëgjimore të datës 09.07.2021, konstaton se analiza e kryer nga audituesi ligjor, i zgjedhur nga subjekti i rivlerësimit, i është nënshtuar debatit gjyqësor sipas parimit të kontradiktoritetit.
19. Bazuar në analizën e mësipërme të situatës faktike procedurale dhe kuadrit ligjor që rregullon procesin e rivlerësimit kalimtar si dhe të jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese dhe GjEDNj-së, trupi gjykues i gjeti të pabazuara pretendimet e subjektit të rivlerësimit për cenimin nga ana e Komisionit të parimeve të procesit të rregullt ligjor.

C. Shkaqet e ankimit që lidhen me kriterin e vlerësimit të pasurisë dhe vlerësimi i trupit gjykues

➤ Lidhur me pasurinë e paluajtshme “zyrë” me sipërfaqe 44,99 m², ndodhur në lagjen “{***}”, Gjirokastër:

20. Subjekti i rivlerësimit kundërshton si të gabuar vlerësimin e Komisionit se: *subjekti i rivlerësimit ka pasur një pamjaftueshmëri financiare për blerjen e pasurisë në fjalë në shumën 1.268.217 lekë (nga të cilat 374.298 lekë për këstin e parë dhe 893.919 lekë për këstin e dytë).*

21. Këtë vlerësim Komisioni e ka bazuar në konstatimet se:

21.1. Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në DIPP-2006 veprimin juridik të kontratës së porosisë me shoqërinë “{***}” ShPK, në kundërshtim me detyrimin për deklarim sipas ligjit, ndonëse e ka saktësuar/plotësuar këtë mangësi në vitin 2009.

21.2. Bazuar në mospërputhjen e çmimit prej 18.000 eurosh, të përcaktuar në kontratën e porosisë së vitit 2007 dhe të deklaruar si të paguar në deklaratat periodike vjetore dhe shumës prej 1.799.600 lekësh, caktuar si çmim në kontratën e shitjes së datës 31.03.2009 dhe të deklaruar në deklaratën *vetting*, vlerësohet se çmimi i kontratës së shitjes është fiktiv.

21.3. Shpenzimet e konsideruara në analizën financiare janë vlera statistikore mesatare për të gjithë vendin si të tilla – duke qenë se janë vlera minimale jetike dhe kompensojnë në favor të subjekteve edhe diferencat e mundshme – ato mbeten në çdo rast më poshtë se niveli i kostove jetike reale dhe nuk lenë hapësira të uljes së tyre poshtë minimumit, në funksion të vendndodhjes së qytetit/fshatit ku ka jetuar familja e subjektit, me përjashtim të rasteve që mund të provohet e kundërta.

21.4. Sipas jurisprudencës⁹ së konsoliduar të Kolegjit, për sa kohë në vitet 2003 dhe 2004 nuk janë deklaruar nga subjekti i rivlerësimit kursime *cash*, pretendimet e mëpasshme për konsiderimin e tyre në analizë financiare nuk mund të pranohen, edhe nëse përgjatë atyre viteve mund të kishte pasur, teorikisht, mundësi kursimi.

21.5. Lidhur me të ardhurat nga bursa e vajzës së subjektit nuk është paraqitur ndonjë dokumentacion shtesë provues mbi bursën e përfutur në vitet 2008, 2010 dhe 2011, për rrjedhojë, duket se ato mbeten në nivel deklarativ, duke marrë në konsideratë çka ka rezultuar e provuar me dokumentacion ligjor.

21.6. Lidhur me shpenzimet e udhëtimit të familjes së subjektit, Komisioni ka pranuar: (i) pretendimet e subjektit mbi shpenzimet ditore prej 20 euro/dita në Janinë në vend të 25 euro të përlllogaritura më herët nga Komisioni; (ii) shpenzimet për kartonin jeshil 1 herë në vit në vlerën 400 euro/vit; si dhe (iii) ka rikonsideruar udhëtimet me autobus, të cilat ulin shpenzimet e përlllogaritura mbi udhëtimet nga 599.956 lekë në 573.599 lekë.

21.7. Lidhur me ligjshmërinë e të ardhurave të ish-bashkëshortit të subjektit, Komisioni ka vlerësuar se nga hetimi administrativ nuk rezultoi e provuar me dokumentacion ligjor ligjshmëria e krijimit të të ardhurave të pretenduara në vitet 2008 dhe 2011 dhe as kryerja e pagesës së detyrimeve tatimore nga punësimi i tij në shtetin grek, të cilat do të shërbenin si burim i ligjshëm për blerjen e pasurisë “zyrë”, duke mos plotësuar kriteret e parashikuara në nenin D të Aneksit të Kushtetutës, për t’i kualifikuar si burime të ligjshme.

⁹ Referuar vendimit nr. 5/2020 (JR), datë 13.03.2020.

21.8. Komisioni, duke e vlerësuar situatën konkrete nën dritën e parimit të proporcionalitetit, ka vlerësuar se analiza financiare e subjektit nuk duhet të rëndohet me shpenzimet jetike të ish-bashkëshortit J. K. përgjatë periudhës 2008 – 2011 që ky i fundit ka jetuar në Greqi, për sa kohë ekzistonte dyshimi i arsyeshëm se ai nuk ka përfituar mjete monetare nga familja e tij për të jetuar kaq gjatë në Greqi, pa të ardhurat e veta.

22. Subjekti i rivlerësimit, në shkakun e ankimit për kundërshtimin si të pabazuar të konkluzionit të mësipërm të Komisionit, ka pretenduar se:

(i) Konkluzioni i Komisionit për pamjaftueshmëri të burimeve të ligjshme për pagesën e kështit të parë dhe të dytë në shumën 1.268.217 lekë, është në kundërshtim me sa vetë Komisioni ka parashtruar në rezultatet e hetimit, ku pamjaftueshmëria ka rezultuar për kështin e dytë dhe të tretë.

(ii) Për këtë pasuri nuk është nënshkruar një kontratë porosie në vitin 2006 por, vetëm një aktmarrëveshje në vitin 2007 dhe se mosdeklarimi i pagesës prej 5.400 eurosh, e paguar paraprakisht në vitin 2006, është një pasaktësi e korrigjuar në DIPP-2007.

(iii) Mospërputhja e çmimit midis kontratës së shitjes më 31.03.2009 dhe atij të aktmarrëveshjes së vitit 2007, vjen si rezultat i moszbatimit të të gjitha parashikimeve kontraktore, pasi shoqëria e ndërtimit nuk përfundoi punimet në afat. Subjekti pretendon se ulja e çmimit të blerjes në kontratë nuk bazohet vetëm në vlerën e punimeve të pakryera, por kjo ulje ka ardhur si penalitet për shoqërinë e ndërtimit që nuk përmbushi detyrimet kontraktore, prandaj nuk ka vend të flitet për trajtim preferencial.

(iv) Komisioni ka mbajtur qëndrim të ndryshëm në çështje të ngjashme që lidhen me ndryshimin e çmimit të blerjes së kësaj pasurie¹⁰.

(v) Në lidhje me analizën financiare për krijimin e kësaj pasurie duhet të konsiderohen konkluzionet e arritura nga audituesi ligjor i caktuar prej subjektit të rivlerësimit, i cili është i pavarur dhe zotëron njohuritë e posaçme.

(vi) Komisioni ka gabuar në lidhje me mospërlllogaritjen e të ardhurave të përfituara në vitin 2008 nga dhënia me qira e kësaj pasurie, me arsyetimin se nuk u provua që për këto të ardhura të jetë përmbushur detyrimi i pagimit të detyrimeve tatimore pasi, në rastin kur qiramarrësi është subjekt tatimor, ligji ngarkon atë me mbajtjen në burim të tatimit mbi të ardhurat nga qiraja në cilësinë e agentit tatim mbledhës. Subjekti pretendoi se ndodhet në kushtet e parashikuara në nenin 32, pika 2 të ligjit nr. 84/2016, sa i takon paraqitjes së të dhënave të detajuara për pagesën e tatimit mbi të ardhurat e përfituara nga qiraja.

(vii) Komisioni ka përfshirë në analizën financiare shpenzime më të larta udhëtimi në vitin 2008, në shumën 599.956 lekë, për shkak të përlllogaritjes së gabuar të hyrje-daljeve dhe ditëve të qëndrimit për vajzën dhe ish-bashkëshortin e saj sipas sistemit TIMS, si dhe e ka ngarkuar me shpenzime më të larta për kartonin jeshil, si dhe për faktin se të gjitha udhëtimet trajtohen si turistike, duke e ngarkuar analizën financiare në vlera të konsiderueshme.

¹⁰ Subjekti i rivlerësimit i referohet çështjes se rivlerësimit të subjektit I. B..

(viii) Komisioni duhet të marrë në konsideratë kursimet *cash* të vitit 2003 dhe 2004, sipas tepricës së përlloritur nga vetë ai për këto vite.

(ix) Shpenzimet e jetesës, duhet të llogariten bazuar në të dhënat e *INSTAT-it* për vitin 2006 në qytetin e Gjirokastrës, sipas numrit të anëtarëve të familjes së saj, duke përfshirë vetëm pjesërisht bashkëshortin, për shkak se ka qenë në emigracion.

(x) Shpenzimet për shkollimin e vajzës në Greqi nuk janë përlloritur sipas datës së fillimit të studimeve, dhe Komisioni nuk ka mbajtur në konsideratë se ato janë mbuluar nga bursat e shkollimit në Universiteti Politeknik në Patra Greqi, vërtetuar nga Ministria e Punëve të Jashtme e Greqisë.

(xi) Të ardhurat e ish-bashkëshortit, për vitin 2008 e në vijim (2009, 2010), janë deklaruar bruto në shumën 480.000 lekë dhe në bazë të ligjit të kohës ato duhet të përlloriten në vlerën neto 378.240 lekë.

(xii) Komisioni e konsideron të paguar shumën 3.600 euro në vitin 2008, edhe pse kjo pagesë nuk mbështetet në asnjë provë.

(xiii) Në analizën financiare të vitit 2008, Komisioni nuk ka analizuar dhe as ka marrë në konsideratë observacionet e paraqitura prej subjektit pas kalimit të barrës së provës dhe është në kontradiktë në arsyetimin që i ka bërë shpenzimeve të vajzës së saj në shtetin grek.

(xiv) Ka kontradiktë mes tabelës së analizës në pikën 35 të vendimit, ku viti 2008 rezulton me mungesë në shumën (-) 920.276 lekë, ndërkohë që në tabelën e analizës financiare mungesa rezulton në shumën (-) 890.919 lekë, dhe se ndryshe nga sa konkludon Komisioni, balanca për vitet 2006, 2007, 2008, rezulton pozitive përkatësisht në vlerën (+) 216.745 lekë, (+) 397.738 lekë dhe (+) 194.167 lekë dhe, si rrjedhojë, burimi i krijimit të pasurisë është tërësisht i ligjshëm.

23. Trupi gjykues, pasi analizoi pretendimet e subjektit të rivlerësimit për këtë shkak ankimi, bazuar në aktet e fashikullit të Komisionit në raport me arsyetimin e vendimit të Komisionit objekt kontrolli, konstaton dhe vlerëson si më poshtë.

24. Në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Një ambient zyre lagje “{***}” Gjirokastrë blerë me kontratën nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 31.03.2009, regjistruar në ZRPP nr. {***}, datë 18.12.2014. Burimi i krijimit pjesa e plotë përfituar nga pjesëtimi i pasurisë me ish-bashkëshortin me deklaratë noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 06.02.2014. Vlera: 1.799.600 lekë, pjesa takuese: 100 %.*

25. Kjo pasuri është deklaruar për herë të parë nga subjekti i rivlerësimit në DIPP-2007: *Një zyrë 45 m² në qytetin e Gjirokastrës në bashkëpronësi me bashkëshortin. Nuk është përpiluar kontrata përfundimtare as hipoteka. Vlera: 18.000 euro (tetëmbëdhjetë mijë) “dhënë paradhënie”, pjesa: 50%. Në vijim, më datë 09.01.2009, nga ana e subjektit të rivlerësimit është bërë plotësimi/saktësimi i DIPP- 2007, ku subjekti ka deklaruar: Zyrë me sipërfaqe 45 m² në qytetin e Gjirokastrës. Kontrata e porosisë është lidhur në muajin maj, viti 2006 me shoqërinë “{***}” dhe është paguar kësti i parë, në shumën 5.400 euro, shumë të cilën e kam siguruar nga kursimet e vitit 2005 dhe kursimet deri në prill 2006. Në muajin shkurt 2007, kam paguar këstin e dytë në*

vlerën 9.000 euro dhe kjo shumë është siguruar nga kursimet maj 2006 – shkurt 2007. Mbetet pa u shlyer shuma 3.600 euro. Vlera: 18.000 euro. Pjesa takuese: 100 %. Në të njëjtin deklaram plotësues/saktësues, më datë 09.01.2009, subjekti ka deklaruar gjithashtu se gjendja *cash* e vitit 2006 është pakësuar në vitin 2007, në shumën 750.000 lekë. Megjithatë, referuar deklarimeve të subjektit nga viti 2003 e deri në vitin 2007, nuk rezulton të jenë deklaruar kursime të disponuara në gjendje *cash* në banesë. Sakaq, në DIPP- 2008, subjekti ka deklaruar: *Një zyrë 46 m² në qytetin e Gjirokastrës e shlyer përfundimisht e dhënë me qira. Është në procedurë hipotekimi, nuk është marrë dokumenti. Vlera: 18.000 euro, pjesa takuese: 100 %. Në rubrikën detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë, subjekti ka deklaruar detyrim në vlerën 3.600 euro, i mbetur nga viti 2007, për shlyerjen e zyrës në total 18.000 euro. Ky detyrim u shlye me këstin përfundimtar në nëntor 2008. Shlyerja u bë me kursimet nga të ardhurat e familjes, por edhe nga qiraja.*

26. Gjatë hetimit administrativ, Komisioni, referuar deklarimeve të subjektit të rivlerësimit në deklaramet periodike ndër vite, çmimit të përcaktuar në kontratën e shitblerjes së vitit 2009¹¹ dhe atij të deklaruar në deklaratën *vetting* prej 1.799.600 lekësh, nëpërmjet pyetësorit nr. 2 i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit të japë shpjegime lidhur me mospërputhjen midis shumës së paguar për blerjen e pasurisë në fjalë, dhe asaj të përcaktuar në kontratën e shitjes nr. {***}, datë 31.03.2009. Në përgjigje të sa më sipër, subjekti ka shpjeguar se: *Marrëveshja paraprake për blerjen e zyrës ishte për shumën 18.000 euro dhe pagesat e kryera në lidhje me këtë kontratë kanë qenë 5.400 euro në 24.05.2006 dhe 9.000 euro në 21.02.2007. Vlera prej 18.000 euro ishte rënë dakord për zyrë të dorëzuar me të gjitha punimet e kryera. Duke qenë se nga ana e shoqërisë së ndërtimit nuk u përfunduan të gjitha punimet, konkretisht vendosja e pllakave dhe pajisjet hidrosanitare, ramë dakord që zyra do blihej nga ana jonë e papërfunduar për vlerën 1.800.000 lekë dhe punimet e papërfunduara do i kryenim vetë. Shumat e paguara prej nesh në totalin 14.400 euro, me kursin e kohës përktetheheshin në 1.800.000 lekë dhe për pasojë ne nuk kemi kryer asnjë pagesë shtesë. Në mbështetje të sa më sipër, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur deklaratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 05.03.2021, të lëshuar nga dy prej tre ish-ortakëve¹² të shoqërisë “{***}” ShPK, të cilët kanë deklaruar se palët fillimisht kishin rënë dakord për çmimin 18.000 euro për një objekt të përfunduar dhe se nga ana e palës blerëse është paguar vetëm shuma prej 1.800.000 lekësh, duke qenë se objekti ishte dorëzuar i papërfunduar. Po ashtu, së bashku me përgjigjet e pyetësorit nr. 2 të Komisionit, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur një faturë për furnizimin me energji elektrike të abonentëve të rinj, të datës 18.02.2008, sipas së cilës, ish-bashkëshorti i subjektit ka kryer pagesat për lidhjen e re të instaluar në zyrë, çka tregon se, së paku në muajin*

¹¹ Nga shqyrtimi dhe analizimi i dokumentacionit të disponuar nga Komisioni, si dhe të deklarimeve të vetë subjektit në DPV-të ndër vite, është konstatuar se kontrata e shitblerjes së pasurisë është nënshkruar në datë 31.03.2009, ndërkohë që referuar deklarimeve të subjektit, shuma prej 18.000 eurosh është shlyer plotësisht në muajin nëntor të vitit 2008.

¹² Shoqëria ka pasur ortakët F. Ç. me 33.34% të aksioneve, F. H. me 33.33% të aksioneve dhe A. P. me 33.33% të aksioneve. Referuar ekstraktit të shoqërisë (në www.qkb.gov.al), rezulton se shoqëria është në likuidim e sipër prej datës 01.02.2010.

shkurt të vitit 2008¹³, subjekti ka marrë në dorëzim zyrën nga shoqëria ndërtuese, ndërkohë që pagesa prej 3.600 eurosh është deklaruar nga vetë subjekti në DIPP-2008, si detyrim i mbetur nga viti 2007, shlyer në muajin nëntor të vitit 2008.

27. Po ashtu, Komisioni, nëpërmjet pyetësorit nr. 3, i ka kërkuar subjektit të sqarojë se sa kanë qenë shpenzimet e kryera prej saj për përfundimin e punimeve të pasurisë në fjalë. Në përgjigje të sa më sipër, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se punimet e kryera kanë qenë shtrimi me pllaka dhe pajisjet hidrosanitare, të cilat në total kanë qenë në masën 50.000 lekë. Në mbështetje të sa më sipër, subjekti ka paraqitur një deklaratë noteriale të datës 16.04.2021, të lëshuar nga shtetasi D. Gj., i cili ka deklaruar se si përfaqësues i shoqërisë “D. Gj., Person Fizik”¹⁴, me NIPT {***}, në vitin 2008 ka blerë materialet dhe ka kryer punimet e ndërtimit në zyrën e z. J. K. dhe se është paguar nga ky i fundit në vlerën totale 50.000 lekë.
28. Referuar deklaramit shtesë të subjektit në DIPP-2007, më datë 09.01.2009, Komisioni i ka kërkuar subjektit, të paraqesë kontratën e porosisë së nënshkruar për këtë pasuri në maj të vitit 2006. Në përgjigje të kërkesës së Komisionit, subjekti i rivlerësimit është shprehur se nuk kujton të ketë nënshkruar ndonjë kontratë të tillë dhe ka vënë në dispozicion një aktmarrëveshje të nënshkruar nga administratori i shoqërisë shitëse z. A. P. dhe ish-bashkëshorti i subjektit, z. J. K., më datë 27.02.2007, në të cilën palët kanë rënë dakord për objektin, zyrë me sipërfaqe 45.26 m², me vlerë 18.000 euro, shumë kjo që do të paguhej me këste. Në këtë aktmarrëveshje palët kanë deklaruar ndër të tjera, se shoqëria shitëse ka marrë nga blerësi J. K. këstin e parë (pa shumë të përcaktuar), ndërkohë që referuar mandateve të pagesës së paraqitura nga subjekti, duket se deri në datën e nënshkrimit të këtij dokumenti, ishin likuiduar dy këste, konkretisht shuma prej 5.400 eurosh më datë 24.05.2006 dhe 9.000 euro më datë 21.02.2007.
29. Në vlerësim të sa më sipër, trupi gjykues konstaton se deklaramet e subjektit të rivlerësimit në deklaramtën *vetting* si dhe gjatë hetimit administrativ, sa i takon çmimit të blerjes së pasurisë objekt shqyrtimi nuk janë në një linjë me deklaramet e kryera në DIPP-2007 (me shtesat/plotësimet e bëra nga subjekti i rivlerësimit në datën 09.01.2009) dhe deklaramtat vijuese periodike si dhe nuk përputhen me dokumentacionin e dorëzuar në kuadër të detyrimit ligjor të parashikuar nga neni 32, pika 1 e ligjit nr. 84/2016. Bazuar në parashikimin ligjor të nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, sipas së cilës deklaramtat e interesave privatë dhe pasurorë të paraqitura në ILDKPKI kanë vlerën e provës, trupi gjykues, konsideroi se deklaramet e subjektit të rivlerësimit në deklaramtat periodike përbëjnë provë të faktit lidhur me marrëdhënien juridike mes shoqërisë së ndërtimit dhe ish-bashkëshortit të subjektit, vlerën e paguar për blerjen e kësaj pasurie dhe burimet e të ardhurave të përdorura për krijimin e saj.

¹³ *Qiradhënia e pasurisë në fjalë ka filluar nga data 01.03.2008.*

¹⁴ *Nga kontrolli në faqen zyrtare të QKB, është konstatuar se kjo shoqëri është regjistruar pranë kësaj të fundit, në datë 23.01.2015, pra shumë vite pas pretendimit të kryerjes së punimeve në fjalë, çka duket se bie ndesh dhe nuk provon vërtetësinë e deklaramit të mësipërm si dhe të vlerës së shpenzimeve të pretenduara.*

30. Edhe nëse pranohet pretendimi i subjektit se në vitin 2006 nuk është nënshkruar një kontratë porosie, për sa kohë, referuar mandat-arkëtimit të vitit 2006 rezulton se nga ish-bashkëshorti i subjektit është paguar kësti i parë për blerjen e kësaj pasurie në shumën prej 5.400 eurosh, kjo pagesë dhe pjesa e papaguar e çmimit duhej të ishte deklaruar në DIPP-2006, në kuptim të detyrimeve që burojnë nga ligji nr. 9049, datë 10.04.2003, të paktën në rubrikën e detyrimeve financiare ndaj personave juridikë/fizikë. Ndonëse subjekti pretendoi se mosdeklarimi i pagesës në shumën 5.400 euro në vitin 2006 është një pasaktësi e korrigjuar në DIPP-2007, referuar kësaj deklaratë, konstatohet se pasuria objekt shqyrtimi është deklaruar për herë të parë në DIPP-2007, ku njëkohësisht subjekti ka deklaruar se për këtë pasuri çmimi prej 18.000 eurosh është dhënë paradhënie. Shlyerja e kështit të parë prej 5.400 eurosh është deklaruar me deklarimin plotësues/sqarues në DIPP-2007 që subjekti ka bërë më datë 09.01.2009, ku rezulton të ketë deklaruar se për pasurinë zyrë me sipërfaqe 45 m², është lidhur kontrata e porosisë në muajin maj të vitit 2006 me shoqërinë “{***}” ShPK si dhe se është kryer pagesa e kështit të parë në shumën 5.400 euro dhe në muajin shkurt 2007 është kryer pagesa e kështit të dytë në shumën 9.000 euro. Sa më sipër, ndonëse duket se subjekti i rivlerësimit e ka korrigjuar pasaktësinë mbi mosdeklarimin e kontratës së porosisë si dhe pagesës së kështit të parë, në aspektin kohor, deklarimi i marrëdhënies së porosisë dhe i pagesës prej 5.400 eurosh është bërë realisht në vitin 2009 dhe jo në vitin 2007, sikurse pretendohet nga subjekti. Sakaq, deklarimet në deklaratën plotësuese/sqaruese të DIPP-2007 më datë 09.01.2009 konfirmojnë konstatimin se çmimi i dakordësuar mes palëve për blerjen e kësaj pasurie ka qenë 18.000 euro, për të cilën është lidhur kontrata në muajin maj 2006 si dhe detyrimin e mbetur pa shlyer ndaj shoqërisë ndërtuese në shumën prej 3.600 eurosh.
31. Në DIPP-2008, dorëzuar më datë 09.03.2009, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar shlyerjen e kështit të fundit prej 3.600 eurosh, si dhe ka konfirmuar shlyerjen totale të vlerës 18.000 euro për pasurinë objekt shqyrtimi. Ndërkohë që, vetëm disa ditë më vonë, në kontratën shitjes së datës 31.03.2009, çmimi i blerjes së kësaj pasurie deklarohet 1.800.000 lekë.
32. Referuar sa më sipër, rezulton se subjekti i rivlerësimit jo vetëm nuk ka deklaruar në kohë dhe saktësisht veprimet juridike dhe ato financiare të kryera prej personit të lidhur, por se shpjegimet e saj në raport me sa ka deklaruar dhe provuar në lidhje me kontratën e porosisë dhe çmimin e paguar për këtë pasuri janë kontradiktore dhe mbeten të paprovuara.
33. Trupi gjykues vlerëson se Komisioni ka konstatuar drejt situatën faktike sa i takon çmimit të objektit “zyrë” me sipërfaqe 44,9 m², në vlerën totale prej 18.000 eurosh. Sa i takon çmimit të përcaktuar në kontratën e shitjes të datës 31.03.2009, në kushtet kur rezultoi e deklaruar nga vetë subjekti i rivlerësimit se ka parapaguar në favor të palës ndërtuese shumën 18.000 euro, dhe për sa kohë nuk u provuan në asnjë rast faktet dhe rrethanat lidhur me pretendimin për gjendjen e pasurisë në momentin e dorëzimit¹⁵, apo situata në lidhje me penaltitetet për vonesën e dorëzimit

¹⁵ Bashkëngjitur deklaratës vetting, subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar kontratën nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 04.03.2008, të nënshkruar nga ish-bashkëshorti i saj në cilësinë e qiradhënësit dhe subjektit politik {***}, Dega

nga ndërtuesi që mund të kenë shërbyer për uljen e çmimit të dakordësuar dhe të paguar paraprakisht, pretendimet e subjektit të rivlerësimit mbeten thjesht deklarative, por para së gjithash në kundërshtim të hapur me deklaratimet e subjektit në deklaratat periodike vjetore të cilat në kuptim të nenit 32, pika 5 të ligjit nr. 84/2016, përbëjnë provë në këtë proces.

34. Në lidhje me pretendimin e subjektit për qëndrime të ndryshme të relatorit të çështjes lidhur me çmimin e blerjes për pasuri të njëjta, në të njëjtën godinë, në pronësi të subjekteve të tjera, trupi gjykues vlerëson se një pretendim i tillë i subjektit të rivlerësimit nuk mund të përbëjë *a priori* shkak për të konsideruar të padrejtë vendimin objekt shqyrtimi, pasi çdo vendimmarrje e Komisionit vlerësohet në mënyrë individuale, bazuar në specifikat e situatës faktike të konstatuara nëpërmjet provave të marra gjatë gjykimit dhe mënyrën e zbatimit të ligjit mbi këtë situatë konkrete faktike. Për rrjedhojë, ky pretendim i subjektit vlerësohet i pabazuar.
35. Pavarësisht sa më lart, në kushtet kur Komisioni nuk e ka kualifikuar konkluzionin e tij se çmimi në kontratën e shitjes ka qenë fiktiv në ndonjë nga parashikimet e nenit 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vlerëson se konkluzioni për çmimin real prej 18.000 eurosh i ka shërbyer Komisionit vetëm për analizën financiare të vlerësimit të mjaftueshmërisë së burimeve financiare për krijimin e pasurisë “zyrë”.
36. Në lidhje me pretendimin e subjektit se konkluzioni i Komisionit në paragrafin 59 të vendimit objekt kontrolli për pamjaftueshmëri për këstin e parë dhe të dytë, në shumën 1.268.217 lekë, është në kundërshtim me sa vetë Komisioni ka parashtruar në rezultatet e hetimit, ku pamjaftueshmëria ka rezultuar për këstin e dytë dhe të tretë, nga kontrolli dhe analizimi i rezultateve të hetimit, trupi gjykues konstaton se Komisioni, në rezultatet e hetimit, ka arritur në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka pasur mundësi për kryerjen pagesës për këstin e parë me burime të ligjshme financiare, ndërsa sa i takon pagesës së kësteve të dytë dhe të tretë, ka konstatuar si dhe i ka kaluar subjektit barrën e provës për mungesë të burimeve financiare të ligjshme për kryerjen e pagesave për blerjen e njësisë në analizë, si dhe realizimin e kursimeve të pretenduara në vitet 2006 dhe 2008, në total prej (-)1.667.482 lekësh, nga të cilat (-) 747.206 lekë për pagesën e këstit të dytë dhe (-) 920.276 lekë për pagesën e këstit të tretë. Konkluzioni në paragrafin 59 të vendimit se: *[...] subjekti i rivlerësimit ka pasur pamjaftueshmëri financiare për blerjen e pasurisë në fjalë, në shumën 1.268.217 lekë (nga të cilat 374.298 lekë për këstin e parë dhe 893.919 lekë për këstin e dytë)*, është arritur nga Komisioni pas rishikimit të analizës financiare sipas prapësimeve të subjektit ndaj rezultateve të hetimit, ku janë pranuar pjesërisht pretendimet e subjektit të rivlerësimit sa i takon shpenzimeve të jetesës së ish-bashkëshortit gjatë periudhës që ai ka jetuar si emigrant në Greqi. Sa më sipër, pavarësisht se në konkluzionin në paragrafin 59 të vendimit, Komisioni, pamjaftueshmërinë e burimeve financiare, e lidh me këstin e parë dhe të dytë, nga analizimi i këtij konkluzioni në harmoni me rezultatet e hetimit, shpjegimet e subjektit pas kalimit të barrës së provës dhe arsyetimin e vendimit në paragrafët e tjerë të tij, rezulton se mënyra se si

Gjirokastër në cilësinë e qiramarrësit, për dhënie me qira të pasurisë “zyrë” përpara lidhjes së kontratës së shitjes më 31.03.2009.

është shprehur Komisioni në këtë paragraf të vendimit nuk ka të bëjë me ndryshim të qëndrimit të tij sa i takon pamjaftueshmërisë së konstatuar në lidhje me këstin e parë, por duket se është një lapsus në tregimin e kësteve që kanë rezultuar me pamjaftueshmëri të burimeve financiare. Për sa më sipër, vlerësohet se ky lapsus nuk e bën vendimin të cenueshëm.

37. Lidhur me të ardhurat nga dhënia me qira e pasurisë “zyrë”, për periudhën 2008-2016, për të cilat subjekti i rivlerësimit kundërshtoi si të gabuar konkluzionin e Komisionit për mospërfshirjen në analizë financiare të të ardhurave të krijuara nga qiradhënia, me arsyetimin se për një pjesë të tyre nuk provohet pagesa e detyrimeve tatimore në kohën kur ato janë realizuar, por është bërë përgjatë procesit të rivlerësimit, trupi gjykues konstatoi si më poshtë.
38. Subjekti i rivlerësimit, duke filluar nga viti 2008 e në vijim, ka deklaruar në deklaratat periodike vjetore dhënien me qira të njësisë “zyrë”, kundrejt vlerës prej 30.000 lekësh në muaj. Për të provuar sa më sipër, bashkëngjitur deklaratës *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar kontratën nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 04.03.2008, të nënshkruar nga ish-bashkëshorti i saj në cilësinë e qiradhënësit dhe subjektit politik {***}, Dega Gjirokastër, në cilësinë e qiramarrësit. Komisioni i ka kërkuar subjektit, nëpërmjet pyetësorit nr. 2, të paraqesë dokumentacionin ligjor për të provuar pagimin e detyrimeve tatimore përgjatë të gjithë periudhës. Në përgjigje të sa më sipër, subjekti ka paraqitur një deklaratë të datës 21.08.2009 nga subjekti politik {***}, Dega Gjirokastër, në të cilën deklarohet se, për periudhën 01.03.2008 deri në 30.06.2009, janë kryer të gjitha pagesat për qiranë, energjinë elektrike, ujin dhe tatimin mbi qiranë e zyrës, si dhe ka bashkëngjitur edhe një mandatar këtë pranë Raiffeisen Bank, të datës 20.08.2009, me përshkrimin “*tatim qiraje mars 2008 – 30 qershor 2009 për J. K.*”, veprim ky i nënshkruar nga përfaqësuesi i subjektit politik {***}, G. S..
39. Komisioni, në pikën 34 të vendimit objekt kontrolli, në kuadër të analizës financiare për pagimin e këstit të tretë, në shumën 3.600 euro, në nëntor të vitit 2008, të deklaruar në DIPP-në e vitit 2008, ka shpjeguar se në mesin e të ardhurave *ka përlllogaritur të ardhurat nga qiradhënia e zyrës*. Trupi gjykues konstatoi se në këtë analizë, Komisioni ka përlllogaritur të ardhura në shumën 1.307.824 lekë, duke përfshirë edhe të ardhurat nga qiraja për këtë vit, në shumën prej 300.000 lekësh (30.000 lekë x 10 muaj). Njëkohësisht, edhe në aktin e ekspertimit të paraqitur nga vetë subjekti, në analizën financiare për këtë vit, të ardhurat nga qiraja janë përlllogaritur në shumën prej 300.000 lekësh.
40. Gjithashtu, Komisioni, në kuadër të analizës së ligjshmërisë së të ardhurave të deklaruara si të krijuara nga dhënia me qira e pasurisë “zyrë”, në pikën nr. 42 të vendimit, ka arsyetuar se: *[...] Komisioni ka konsideruar si të ardhura me burim të ligjshëm nga qiradhënia ato të periudhës mars 2008 – qershor 2009 dhe të viteve 2015 e 2016, për të cilat është provuar pagesa e detyrimeve tatimore përkatëse. Për periudhat e tjera midis – prej të cilave disa nuk kanë rezultuar të mbuluara me një kontratë qiraje, por dhe ato të mbuluara me një të tillë, ku është specifikuar në kontratë se detyrimin për pagimin e tatimit në burim e ka qiramarrësi – për sa kohë në llogarinë e subjektit të rivlerësimit apo ish-bashkëshortit janë transferuar shumat bruto të qirasë prej 30.000 lekësh/muaj (ndryshe nga çka ndodhur nga qershori i vitit 2017 e në vijim, ku në llogarinë e*

subjektit është transferuar shuma neto e qirasë, pas mbajtjes së tatimit në burim) dhe nuk është mbajtur në burim tatimi mbi këto të ardhura – Komisioni nuk i ka konsideruar në analizën financiare si të ardhura me burim të ligjshëm, në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

41. Në analizë të sa më sipër, trupi gjykues e gjen të pabazuar pretendimin e subjektit të rivlerësimit për mosllogaritjen e të ardhurave nga qiraja për vitin 2008 dhe, si rrjedhojë, kundërshtimi i subjektit të rivlerësimit lidhur me konkluzionin e Komisionit, për ligjshmërinë e një pjese të të ardhurave të realizuara nga dhënia me qira e pasurisë “zyrë”, nuk ka efekt për analizën e burimeve financiare për krijimin e kësaj pasurie, prandaj ai do të trajtohet më poshtë në këtë vendim në kuadër të shkakut të ankimit që lidhet me analizën financiare të subjektit të rivlerësimit për periudhën 2003-2016.
42. Sa i takon pretendimit të subjektit se Komisioni ka përfshirë në analizë financiare shpenzime më të larta udhëtimi në vitin 2008, për shkak të përlllogaritjes së gabuar të hyrje-daljeve dhe ditëve të qëndrimit për vajzën dhe bashkëshortin e saj, shpenzimeve për kartonin jeshil, si dhe se për shkak të faktit se të gjitha udhëtimet trajtohen si turistike, duke e ngarkuar analizën financiare në vlera të konsiderueshme, trupi gjykues konstaton se, lidhur me sa më sipër, Komisioni ka arsyetuar në pikën 56 të vendimit se: *Në përfundim të sa më sipër, lidhur me shpenzimet e udhëtimit të familjes së subjektit, Komisioni ka pranuar: (i) pretendimet mbi shpenzimet ditore prej 20 eurosh/dita në Janinë, në vend të 25 euro/dita, të përlllogaritura më herët nga Komisioni; (ii) prerjen e kartonit jeshil 1 herë në vit, me vlerën 400 euro/vit; si dhe (iii) ka rikonsideruar udhëtimet me autobus, të cilat ulin shpenzimet e përlllogaritura mbi udhëtimet nga shuma 599.956 lekë në shumën 573.599 lekë.*
43. Lidhur me pretendimin e subjektit se, sipas të dhënave në sistemin TIMS, ish-bashkëshorti J. K. ka hyrë në Shqipëri në datën 18.07.2008 me linjën Sarandë-Korfuz, dhe në datën 20.07.2008 ka dalë nga Shqipëria me linjën Sarandë-Korfuz e, për rrjedhojë, nuk mund të ketë qëndruar 14 ditë në Janinë, nga verifikimi i akteve në fashikull, si dhe pas kontrollit dhe verifikimit të kryer nga Njësia e Shërbimit Ligjor i të dhënave të regjistruara në sistemin TIMS, trupi gjykues konstaton se ky udhëtim, i kryer në këto data me hyrje-dalje, me destinacion qytetin e Korfuzit, nuk është kryer nga bashkëshorti i subjektit J. K., por është kryer nga babai i saj J. I., për rrjedhojë ky pretendim i subjektit nuk qëndron.
44. Në lidhje me pretendimin e subjektit se, sipas të dhënave në sistemin TIMS, vajza e saj M. K., në datën 13.07.2008, ka dalje nga Shqipëria nga pika kufitare Kakavijë, dhe në datën 17.08.2008, ka përsëri dalje po nga kjo pikë kufitare, pa pasur ndërkohë të dhëna për datën e hyrjes në Shqipëri, për rrjedhojë, përlllogaritja e ditëve të qëndrimit dhe, për pasojë, shpenzimet e udhëtimit nuk janë përlllogaritur saktë nga Komisioni, pas verifikimit të kryer nga Njësia e Shërbimit Ligjor, e të dhënave të regjistruara nga sistemi TIMS, rezultoi se vajza e subjektit ka dalë me automjet nga Shqipëria nga pika kufitare Kakavijë në datën 13.07.2008, dhe në vijim, në datën 17.08.2008, vajza e subjektit ka dalë me autobus nga Shqipëria nga pika kufitare Kakavijë, por nuk ka të dhëna në sistemin TIMS për hyrje në Shqipëri të kryera nga vajza e subjektit në këtë vit. Për këtë udhëtim,

rezulton se subjekti nuk ka përcaktuar në ankim se sa ditë ka qëndruar vajza e saj jashtë vendit, duke pretenduar vetëm se sistemi TIMS nuk ka të dhëna për hyrjen e vajzës së saj në Shqipëri. Në lidhje me shpenzimet e kryera për këtë udhëtim, për të mos rënduar pozitën financiare të subjektit, në mungesë të të dhënave provuese për ditët e qëndrimit të vajzës jashtë vendit, trupi gjykues vlerësoi se shpenzimet duhen përlogaritur duke konsideruar vetëm një ditë qëndrimi për vajzën e subjektit jashtë vendit, për secilën nga datat e mësipërme, duke ulur kështu shumën e shpenzimeve të përlogaritura nga Komisioni për këtë udhëtim nga shuma 758 euro¹⁶ në shumën 130 euro¹⁷.

45. Në lidhje me pretendimin e subjektit për përlogaritje të pasaktë të shpenzimeve të udhëtimit për ish-bashkëshortin e saj J. K., për periudhën 28.08.2008 - 19.09.2008 (21 ditë), pasi, sipas saj, referuar të dhënave nga sistemi TIMS, ish-bashkëshorti i saj, në datën 29.08.2008, ka hyrë në Shqipëri me linjën Sarandë-Korfuz, në datën 31.08.2008, ka dalë nga Shqipëria me linjën Sarandë-Korfuz dhe, në datën 10.09.2008, ka hyrë në Shqipëri me linjën Sarandë-Korfuz, pas kontrollit të të dhënave të regjistruara në sistemin TIMS nga Njësia e Shërbimit Ligjor, rezultoi se ish-bashkëshorti i saj J. K. ka dalë me automjet në datën 28.08.2008, dhe ka hyrë në Shqipëri në datën 19.09.2008, gjithsej 21 ditë qëndrimi jashtë Shqipërisë, për rrjedhojë, përlogaritjet e shpenzimeve nga Komisioni në lidhje me këtë udhëtim, janë të sakta. Në datat e pretenduara nga subjekti, udhëtimet me linjën Sarandë-Korfuz, pas kontrollit të të dhënave të regjistruara në sistemin TIMS, rezultuan të jenë kryer nga i ati i subjektit J. I., dhe jo nga ish-bashkëshorti i saj J. K..
46. Në lidhje me pretendimin e subjektit se Komisioni, për periudhën 30.07.2008 - 10.08.2008, ka përlogaritur udhëtim me destinacion qytetin e Janinës, për vajzën e saj M. K., për 10 ditë, dhe shpenzime në shumën 558 euro, ndërkohë që, sipas saj, referuar të dhënave në sistemin TIMS, nuk rezulton të ketë asnjë hyrje apo dalje të vajzës së saj në këto data, nga verifikimi i të dhënave sipas sistemit TIMS, rezulton se në këto data ka udhëtuar ish-bashkëshorti i subjektit dhe jo vajza e saj, dhe se Komisioni, për këtë periudhë, ka përlogaritur shpenzime udhëtimi vetëm për ish-bashkëshortin e subjektit dhe jo vajzën e saj, për rrjedhojë, pretendimi i subjekti nuk qëndron.
47. Sa i takon pretendimit të subjektit se Komisioni ka përlogaritur shumën 40 euro për kartonin jeshil për çdo udhëtim në qytetin e Janinës me automjet, dhe se shpenzimi për kartonin jeshil duhet të përlogaritet për 1 vit, në shumën 400 euro, nga verifikimi i përlogaritjeve të kryera nga Komisioni, rezulton se shpenzimet për kartonin jeshil për vitin 2008 fillimisht janë përlogaritur në shumën 40 euro për çdo udhëtim, ndërsa pas shpjegimeve të subjektit në prapësimet ndaj rezultateve të hetimit, Komisioni ka rishikuar përlogaritjen e shpenzimeve të udhëtimit, duke reflektuar në analizën financiare shpenzime për kartonin jeshil, në shumën 400 euro në vit, për rrjedhojë, ky pretendim i subjektit nuk u gjet i bazuar.

¹⁶ Komisioni ka përlogaritur 14 ditë qëndrimi për këtë udhëtim, në shumën 700 euro, dhe 58 euro kosto automjeti (700 euro + 58 euro = 758 euro).

¹⁷ Përlogaritet kosto 65 euro (50 euro për një ditë qëndrimi dhe 15 euro kosto e biletës me autobus) për datën 13.07.2008, ku rezulton dalje e vajzës së subjektit nga Shqipëria, nga pika kufitare Kakavijë, dhe kosto 65 euro për datën 17.08.2008.

48. Në lidhje me pretendimin se udhëtimet nuk duhen trajtuar si udhëtime turistike, pasi udhëtimet me destinacion Janinën, kanë qenë vizita te të afërmit, rezulton se ky është një pretendim i ri i subjektit, i paraqitur në ankim. Komisioni, për këto udhëtime me destinacion qytetin e Janinës, ka përlllogaritur shpenzime në shumën 20 euro për udhëtimet brenda ditës, dhe shumën 50 euro në ditë për udhëtimet disa ditore. Nga verifikimi i akteve në fashikull, nuk rezulton ndonjë akt ku të vërtetohet qëndrimi te të afërmit për këto udhëtime në qytetin e Janinës, për rrjedhojë, ky pretendim i subjektit mbeti në nivel deklarativ dhe nuk u mor në konsideratë nga ana e trupit gjykues.
49. Në përfundim të sa më sipër, trupi gjykues arriti në konkluzionin se pretendimet e subjektit të rivlerësimit lidhur me pasaktësitë në përlllogaritje nga ana e Komisionit, për shpenzimet e udhëtimit për vitin 2008, nuk janë të bazuara, përveç udhëtimeve të kryera nga vajza e subjektit në datat 13.07.2008 dhe 17.08.2008, të cilat nuk do të konsiderohen si udhëtime të kryera për 14 ditë qëndrimi, por do të përlllogariten si një ditë qëndrimi jashtë vendit, duke sjellë, si pasojë, uljen e shpenzimeve të përlllogaritura nga Komisioni për këtë udhëtim, nga 758 euro në shumën 130 euro.
50. Në lidhje me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se Komisioni, në kursimet e vitit 2006, duhet të përlllogarisë edhe kursimet *cash* të vitit 2003 dhe 2004, sipas tepricës së përlllogaritur nga vetë Komisioni për këto vite, nga shqyrtimi i dokumentacionit në fashikullin e Komisionit, si dhe referuar arsyetimit të Komisionit në vendim, trupi gjykues konstatoi se Komisioni ka marrë në konsideratë në përlllogaritjet e kryera deklaratimet e subjektit në deklaratimet periodike ndër vite¹⁸ dhe plotësimet/saktësimet e bëra në deklaratën periodike të vitit 2007, duke përlllogaritur në analizën e burimeve të krijimit të pasurisë “zyrë” kursime *cash*, në vlerën 750.000 lekë, si të krijuar për të gjithë vlerën në vitin 2006.
51. Trupi gjykues vlerësoi se, bazuar në jurisprudencën e konsoliduar të Kolegjit, për sa kohë në vitet 2003 dhe 2004 nuk janë deklaruar kursime *cash*, pretendimet e subjektit për përfshirje në analizën financiare si burim i ligjshëm, për blerjen e pasurisë objekt kontrolli, të tepricave në vitet 2003 dhe 2004, nuk mund të pranohen, edhe nëse përgjatë atyre viteve mund të kishte pasur teorikisht, sipas përlllogaritjeve të analizës financiare, mundësi kursimi. Në këto kushte, mënyra e

¹⁸ Nga shqyrtimi dhe analizimi i deklaratimeve të subjektit në DIPP-të ndër vite, ka rezultuar se subjekti ka deklaruar kursime të disponuara *cash* për herë të parë, në DIPP-në e vitit 2008. Ndërkohë, në plotësimin e kryer në DIPP-në e vitit 2007, rezulton se në faqen nr. 3 të saj gjendet një tjetër fletë e numërtuar me nr. 3, e cila mban datën 09.01.2009, ku subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime lidhur me deklaratimin e kryer prej saj në vitin 2007, duke bërë dy përshkrime shtesë, në rubrikën e “Ndryshimeve dhe Interesave Private Pasuri Paluajtshme dhe të Luajtshme” dhe konkretisht: “Zyrë me sip. 45 m² në qytetin e Gjirokastrës. Kontrata e porosisë është lidhur në muajin maj, viti 2006, me shoqërinë “{***}” ShPK dhe është paguar kësti i parë në vlerën 5.400 euro, shumë të cilën e kam siguruar nga kursimet e vitit 2005 dhe kursimet deri në prill 2006. Në muajin shkurt 2007 kam paguar këstin e dytë në vlerën 9.000 euro dhe kjo shumë është siguruar nga kursimet maj 2006-shkurt 2007. Mbetet pa u shlyer shuma 3.600 euro. “Gjendje *cash* e vitit 2006, e pakësuar në vitin 2007, shuma (-) 750.000 lekë”.

përlllogaritjes së gjendjes *cash* nga ana e Komisioni vlerësohet në përputhje me parashikimet ligjore dhe jurisprudencën e Kolegjit.

52. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit për rilloaritjen e shpenzimeve për jetesë, bazuar në të dhënat e INSTAT-it për vitin 2006, në qytetin e Gjirokastrës, sipas numrit të anëtarëve të familjes së saj, duke përfshirë vetëm pjesërisht ish-bashkëshortin, për shkak se ka qenë në emigracion, nga verifikimi i përlllogaritjeve të kryera nga Komisioni në lidhje me shpenzimet e jetesës për periudhën 2003-2016, trupi gjykues konstatoi se në analizë janë përdorur të dhënat sipas INSTAT-it¹⁹ për konsumin për frymë dhe familjar, ku vlerat e shpenzimeve të jetesës sipas viteve përkatëse, në bazë të frymëve të anëtarëve të familjes së subjektit, janë përlllogaritur saktë dhe në përputhje me metodologjinë e ndjekur nga Kolegji.
53. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se shpenzimet për shkollimin e vajzës në Greqi nuk janë përlllogaritur sipas datës së fillimit të studimeve dhe se Komisioni nuk ka mbajtur në konsideratë se ato janë mbuluar nga bursat e shkollimit në Universiteti Politeknik në Patra, Greqi, vërtetuar nga Ministria e Punëve të Jashtme e Greqisë, trupi gjykues konstatoi se, Komisioni, lidhur me shpenzimet për shkollimin e vajzës së subjektit, ka arsyetuar në vendim se: *Lidhur me të ardhurat nga bursa e vajzës së subjektit, nuk është paraqitur ndonjë dokumentacion shtesë provues mbi bursën e përfituar në vitet 2008, 2010 dhe 2011, për rrjedhojë, duket se ato mbeten në nivel deklarativ, duke marrë në konsideratë çka ka rezultuar e provuar me dokumentacion ligjor.*
54. Në lidhje me sa më sipër, nga verifikimi i analizës financiare të vitit 2008, rezulton se Komisioni ka përlllogaritur shpenzime studimi për vajzën e subjektit, në shumën 221.729 lekë, duke marrë në konsideratë 3 muaj qëndrimi të vajzës së subjektit në Greqi. Referuar DIPP- 2008, rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar të ardhura në masën 600 euro në muaj, të përfituara nga Ministria e Jashtme e Republikës së Greqisë, për të drejtën/bursën e studimit të vajzës në Greqi dhe të përdorura për shpenzimet e studimeve. Gjatë hetimit administrativ, në përgjigje të pyetësorit nr. 1, subjekti ka shpjeguar se vajza e saj ka studiuar në Universitetin e Patras deri në vitin 2010, vit në të cilin ka ndërprerë studimet. Komisioni, nëpërmjet pyetësorit nr. 2, i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit të paraqesë dokumentacionin ligjor që provon bursën e përfituar nga e bija, periudhën në të cilën janë përfituar këto të ardhura, si dhe shpenzimet përkatëse të studimeve. Në përgjigje të sa më sipër, subjekti ka shpjeguar se: *Në lidhje me bursën e përfituar nga vajza, kam paraqitur vërtetim të përkthyer, që M. K. ka qenë e trajtuar me bursë. Sqaroj se lidhur me shumën, me sa më kujtohet, ka qenë standarde, kam kërkuar edhe informacion shtesë lidhur me këtë, por për shkak të pandemisë, nuk mund të udhëtoj për marrje informacioni dhe kërkohet kohë më e gjatë. Së bashku me përgjigjen e mësipërme, subjekti ka paraqitur librezën e studentit të vajzës dhe një vërtetim nga Ministria e Punëve të Jashtme²⁰, sipas së cilës, vajza e subjektit ka përfituar bursë për periudhën 2008–2010, për studimet e saj në Universitetin e Patras. Në kushtet kur, në*

¹⁹ Referuar shkresës nr. {***} prot., datë 04.03.2019, të ILDKPKI-së drejtuar Kolegjit.

²⁰ Drejtoria e Përgjithshme e Bashkëpunimit të Zhvillimit Ndërkombëtar.

përmbajtje të këtij vërtetimi, nuk përcaktohet shuma e bursës së përfituar përgjatë kësaj periudhe, nëpërmjet pyetësorit nr. 3, subjekti është rifituar nga Komisioni të paraqesë dokumentacion provues mbi shumën konkrete të të ardhurave të përfituara nga bursa. Në përgjigjet e saj, subjekti ka shpjeguar se bursat e dhëna nga shteti grek janë standarde, në shumën 600 euro në muaj, si dhe ka sqaruar se kjo shumë mbulonte shpenzimet e jetesës dhe të udhëtimit të vajzës. Subjekti ka sqaruar gjithashtu se universiteti në fjalë është shtetëror dhe studimi, së bashku me materialet mësimore, janë pa pagesë. Së bashku me përgjigjet e saj, subjekti ka paraqitur vërtetimin e datës 22.01.2013, të lëshuar nga Universiteti i Patras, në të cilin është konfirmuar regjistrimi i studentes M. K., më datë 23.10.2008. Po ashtu, ka paraqitur të dhëna mbi disa lëvizje në llogarinë bankare të shtetases M. K. në Bankën Bujqësore të Greqisë, nga ku ka rezultuar se kjo e fundit ka përfituar shumat 3.600 euro, në datën 15.05.2009; 1.800 euro, në datën 03.07.2009; dhe 1.800 euro, në datën 13.10.2009.

55. Për sa më sipër, trupi gjykues vlerësoi se, referuar kësaj shkrese, rezulton se vajza e subjektit është regjistruar për studime në Universitetin e Patras, në fund të muajit tetor të vitit 2008, për rrjedhojë, trupi gjykues vlerësoi se shpenzimet e shkollimit për vitin 2008 duhet të përlllogariten për dy muaj dhe jo për tre muaj, sikurse janë përlllogaritur nga Komisioni. Sa i takon pretendimit të subjektit se në analizën financiare, përveç shpenzimeve të studimit, duhet të përlllogariten edhe të ardhurat e përfituara nga bursa, rezulton se nga Komisioni janë njohur vetëm të ardhurat e provuara, të përfituara në formën e bursës gjatë vitit 2009, të cilat në total arrijnë në shumën 7.200 euro²¹. Nga ana tjetër, Komisioni ka përlllogaritur në analizën financiare, shpenzimet e jetesës për periudhën tetor 2008 – shkurt 2011, të vajzës së subjektit në shtetin grek, të barabarta me vlerën e bursës së përfituar prej saj nga Ministria e Punëve të Jashtme. Në vlerësim të sa më sipër, trupi gjykues çmoi se, pavarësisht se dokumentacioni i paraqitur nga subjekti i rivlerësimit nuk përcakton shumën totale të përfituar nga vajza e subjektit apo bazën mujore të këtyre të ardhurave, ai gjithsesi jep informacionin se vajza e subjektit të rivlerësimit përgjatë periudhës 2008 – 2010, kohë kur ka ndjekur studimet në shtetin grek, ka përfituar bursë, e cila është përdorur për të mbuluar shpenzimet e saj për shkollim. Në këtë analizë, trupi gjykues mban në konsideratë edhe faktin se të ardhurat nga bursa janë deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në DIPP-në e vitit 2008²². Sa më sipër, trupi gjykues e gjen të bazuar pretendimin e subjektit të rivlerësimit për përfshirjen e të ardhurave nga bursa e studimit të vajzës së saj në Greqi, për periudhën 2008 - 2010, sipas vërtetimit të lëshuar nga Ministria e Punëve të Jashtme e Greqisë, si dhe pretendimin se në vitin 2008, shpenzimet për studime duhet të përlllogariten për dy muaj qëndrim. Sa më sipër, nga

²¹ Shuma prej 7.200 eurosh rezulton si e ardhur e vajzës së subjektit, referuar lëvizjeve bankare nga Banka Bujqësore e Greqisë, ku rezultojnë kreditime në llogarinë e vajzës së subjektit me përshkrimin “depozitë me bursë nga Ministria e Jashtme”, në shumën 3.600 euro, në datën 18.05.2009; në shumën 1.800 euro, në datën 06.07.2009; dhe në shumën 1.800 euro, në datën 14.10.2009.

²² Subjekti ka deklaruar për herë të parë të ardhurat për fëmijën me të drejtë shkollimi të përfituar për jashtë shtetit. Në deklaratat periodike të vitit 2009 dhe vitit 2010, nuk rezulton të jenë deklaruar nga subjekti të ardhura nga shkollimi, sikurse ka deklaruar në deklaratën periodike të vitit 2008.

rishikimi i analizës financiare për vitin 2008, sipas pretendimeve të subjektit, balanca negative e vitit 2008 do të reduktohet në 591.730 lekë, por rezulton e pamjaftueshme për ta përmbysur atë²³.

56. Në lidhje me pretendimin e subjektit për përlogaritjen në analizën financiare të të ardhurave nga paga e bashkëshortit, në shumën 378.240 lekë, të deklaruara në DIPP-në e vitit 2008, në shumën e pagës bruto prej 480.000 lekësh, trupi gjykues konstatoi se, për këto të ardhura, Komisioni ka vlerësuar se: *nga hetimi administrativ nuk rezultoi e provuar me dokumentacion ligjor ligjshmëria e krijimit të të ardhurave të pretenduara në vitet 2008 dhe 2011 dhe as kryerja e pagesës së detyrimeve tatimore nga punësimi i tij në shtetin grek, të cilat do të shërbenin si burim i ligjshëm për blerjen e pasurisë “zyrë”. Nga sa është administruar, shqyrtuar dhe vlerësuar nga Komisioni, mbi këtë pikë, nuk ka rezultuar e provuar me dokumente ligjore marrëdhënia e punësimit, fitimet e realizuara, si dhe tatimet e kontributet e paguara në raport me këto të ardhura, pasi pretendimet në fjalë mbeten në nivel deklarativ, qofshin ato të bazuara edhe mbi deklaramë të personave të tretë, të bëra përpara autoriteteve të huaja, të cilat nuk mund t’u veshin/atribuonjë këtyre të ardhurave ligjshmërinë faktike e tatimore, për sa kohë nuk mbështeten në dokumente të lëshuara nga autoritetet kompetente tatimore dhe sigurime shoqërore. Kësisoj, pretendimet e subjektit në këtë pikë mbeten të paprovuara lidhur me ligjshmërinë dhe në vijueshmërinë e këtyre të ardhurave, për sa kohë mungojnë provat e mirëfillta si në aspektin sasior, ashtu edhe në atë cilësor, duke mos plotësuar kriteret e parashikuara në nenin D të Aneksit të Kushtetutës, për t’i kualifikuar si burime të ligjshme.*
57. Në deklaratën *vetting*, subjekti ka deklaruar të ardhurat nga paga e ish-bashkëshortit në shoqërinë “{***}” ShPK nga 01.02.2009 deri 31.12.2010, në shumën 793.960 lekë, si dhe ka bashkëlidhur vërtetimin nr. {***} prot., datë 20.01.2017, nga Dega e Sigurimeve Shoqërore Sarandë, nëpërmjet të cilit vërtetohet se z. J. K. është i siguruar pranë subjektit “{***}”, Sarandë, me NIPT {***}, për periudhën 01.02.2009 - 31.12.2010. Këto të ardhura janë deklaruar për herë të parë në DIPP-të e viteve 2007 dhe 2008, ku subjekti i rivlerësimit ka deklaruar të ardhura të ish-bashkëshortit të saj si i punësuar në shoqërinë “{***}” ShPK, Sarandë, në shumën 40.000 lekë në muaj. Në DIPP-2009, subjekti deklaroi: *Paga e bashkëshortit në shoqërinë “{***}” Sarandë, e pandryshuar me deklaramë e vitit të mëparshëm 40.000 lekë/muaj.* Në DIPP-2010, subjekti ka deklaruar: *Të ardhura nga paga e bashkëshortit në shoqërinë “{***}”²⁴ [...] në vlerën 30.000 lekë në muaj.* Në DIPP-2011, subjekti deklaroi: *Të ardhura të bashkëshortit, paga mujore, në vlerën 40.000 lekë në muaj.*
58. Gjatë hetimit administrativ, nëpërmjet pyetësorit nr. 2, Komisioni e ka ftuar subjektin të paraqesë dokumentacionin ligjor që provon marrëdhënien e punësimit të ish-bashkëshortit, për periudhën janar 2008 – janar 2009 dhe janar 2011 – dhjetor 2011, si dhe të ardhurat e përfituara prej tij gjatë

²³ Duke marrë në konsideratë në analizën financiare të vitit 2008 dhe vitit 2010, të ardhurat nga bursa për vitin 2008 dhe 2010 (jo për vitin 2011, për shkak se nuk ka prova për përfitimin e bursës në këtë vit), balanca negative e vitit 2008 reduktohet, ndërsa viti 2010 përlogaritet me balancë pozitive, reflektuar në analizën financiare të periudhës 2003-2016.

²⁴ Jo “{***}”, siç e ka deklaruar në deklaratat e mëparshme.

kësaj periudhe, të cilës subjekti i është përgjigjur se nuk ka të dhëna zyrtare për vitin 2011, duke bashkëlidhur si dokumentacion provues Librezën e Kontributeve të Sigurimeve Shoqërore. Në lidhje me sa më sipër, Komisioni ka administruar përgjigjet nr. {***} prot., datë 07.04.2021 dhe nr. {***} prot., datë 07.04.2021, nga Dega e Arkivit të Rajonit Tiranë, pranë Drejtorisë së Arkivit Qendror të Institutit të Sigurimeve Shoqërore, sipas të cilave rezultoi se nuk përftohet informacion apo të dhëna mbi listëpagesat nga shoqëria “{***}”, Sarandë, për periudhën 2008-2011²⁵.

59. Në analizë të pretendimeve të subjektit për të ardhurat e ish-bashkëshortit të saj për periudhën 2008 - 2011, rezulton se Komisioni ka analizuar të gjitha të ardhurat e deklaruara nga subjekti për ish-bashkëshortin, duke pranuar dhe përllogaritur vetëm ato të ardhura për të cilat është vërtetuar se janë paguar detyrimet tatimore dhe sigurimet shoqërore e shëndetësore, konkretisht viti 2009 dhe viti 2010²⁶. Ndërkohë që për vitet 2008 dhe 2011, nuk janë përllogaritur të ardhura, për sa kohë nuk janë provuar nga ana e subjektit pagesa e detyrimeve në përputhje me parashikimet e nenit 30 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës.
60. Sa i takon pretendimit të subjektit se Komisioni ka përllogaritur në analizë financiare shlyerjen e kështit të tretë, në shumën 3.600 euro, edhe pse kjo pagesë nuk mbështetet në asnjë provë, trupi gjykues konstaton se pagesa e kështit të tretë është deklaruar në deklaratën periodike të vitit 2008, në rubrikën “Ndryshimet e interesave privatë, pasuri të paluajtshme dhe të luajtshme”, me përshkrim: *Një zyrë 46 m² në qytetin e Gjirokastrës, e shlyer përfundimisht, e dhënë me qira, shuma 18.000 euro.* Po ashtu, në rubrikën “Detyrimet financiare”, me përshkrimin: *Detyrimi në vlerën 3.600 euro, i mbetur nga viti 2007, për shlyerjen e zyrës në total 18.000 euro. Ky detyrim u shlye me kështin përfundimtar në vitin 2008. Shlyerja u bë me kursimet nga të ardhurat e familjes por edhe nga qiraja, shuma 3.600 euro.* Nisur nga vlera provuese që u jepet deklarimeve periodike vjetore, sipas parashikimeve të nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vlerëson se këto deklarime, si gjurmë të kohës, përbëjnë provë të mjaftueshme për të provuar pagesën e kështit të tretë dhe për ta konsideruar atë si shpenzim në analizën financiare të subjektit, në përputhje me qëndrimin e mbajtur nga Komisioni. Në këto kushte, trupi gjykues vlerëson se pretendimi i subjektit se kjo pagesë nuk bazohet në asnjë dokument, nuk qëndron.
61. Sa i takon pretendimit të subjektit për kontradiktë mes tabelës së analizës në pikën 35 të vendimit, ku viti 2008 rezulton me mungesë në shumën (-) 920.276 lekë, ndërkohë që në tabelën e analizës financiare mungesa rezulton në shumën (-) 890.919 lekë, trupi gjykues konstaton se pika 34²⁷ e vendimit është shpjegimi i rezultatit të hetimeve, para se subjekti të sillte prapësimet dhe parashtrimet e tij, një pjesë e të cilave, pasi u vlerësuan nga Komisioni, u morën në konsideratë dhe po ashtu u reflektuan në tabelën e analizës financiare, ku vlerat negative janë ulur, duke

²⁵ Ekstrakt nga shkresa: “Nga verifikimi i bërë në DAQ Lundër për subjektin “{***}”, me Nipt {***}, dhe nr. dosje {***}, për periudhën 2008-2011, nuk administrojmë listëpagesa deri tani”.

²⁶ Sipas vërtetimit nr. {***}, datë 20.01.2017, nga Dega e Sigurimeve Shoqërore Sarandë.

²⁷ Numërtimi i pikave të arsytimit të vendimit të Komisionit pasqyrohet sipas numërtimit të kopjes së vendimit në fashikullin e Komisionit, i cili rezulton të jetë i ndryshëm nga vendimi i publikuar në faqen e internetit të Komisionit, të cilit i referohet subjekti i rivlerësimit.

përmirësuar pozitën financiare të subjektit të rivlerësimit. Konkretisht, referuar paragrafit 56 të arsyetimit të Komisionit, rezulton se ky i fundit ka pranuar pretendimet e subjektit për përlllogaritjen e shpenzimeve ditore 20 euro/dita në Janinë, prerjen e kartonit jeshil një herë në vit në vlerën 400 euro, po ashtu ka rikonsideruar udhëtimet me autobus dhe shpenzimet e jetesës së ish-bashkëshortit për periudhën 2008 - 2011²⁸, duke bërë që vlerat negative të pasqyruara në rezultatet e hetimit të përmirësohen në favor të subjektit. Sa më sipër, pretendimi i subjektit vlerësohet i pambështetur.

62. Bazuar në analizën e mësipërme të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit për shkakun e ankimit që lidhet me burimet financiare të ligjshme për krijimin e pasurisë “zyrë”, trupi gjykues, pas rishikimit të analizës financiare të Komisionit nëpërmjet Njësisë së Shërbimit Ligjor, konstatoi se, për pagimin e këstit të parë prej 5.400 eurosh, subjekti rezultoi me balancë pozitive. Për pagesën e këstit të dytë prej 9.000 eurosh, trupi gjykues konstatoi të njëjtin rezultat si Komisioni, me mungesë të burimeve financiare të ligjshme, në shumën (-) 374.298 lekë. Për pagesën e këstit të tretë prej 3.600 eurosh, në muajin nëntor 2008, pasi u përlllogaritën për vajzën e subjektit të ardhura nga bursa për dy muaj, në shumën 1.200 euro, dhe shpenzimet e jetesës në shumën 1.200 euro për dy muaj dhe jo 1.800 euro për 3 muaj, si përlllogaritur nga Komisioni, si dhe u përlllogaritën shpenzimet e udhëtimeve të kryera nga vajza e subjektit, në datën 13.07.2008 dhe në datën 17.08.2008, me nga 1 ditë qëndrimi jashtë vendit, duke reduktuar shpenzimet e përlllogaritura nga Komisioni nga shuma 758 euro në shumën 130 euro, trupi gjykues konstatoi se subjekti i rivlerësimit, në momentin e pagimit të këtij kësti në nëntor 2008, kishte mungesë të burimeve financiare të ligjshme për pagimin e tij, në shumën (-) 591.730 lekë.

63. Në përfundim të analizimit të shkakut të ankimit lidhur me krijimin të pasurisë “zyrë”, me sipërfaqe 44,99 m², ndodhur në lagjen “{***}”, Gjirokastër, trupi gjykues arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për justifikimin e kësaj pasurie, duke u gjendur në kushtet e nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.

➤ Lidhur me tri pasuritë “truall/shesh ndërtimi”, të ndodhura në Sarandë dhe në Komunën Dropull i Poshtëm, Gjirokastër:

64. Subjekti i rivlerësimit kundërshton në ankim vlerësimin e Komisionit për pasuritë: (i) “truall/shesh ndërtimi” me sipërfaqe 400 m², në emër të subjektit të rivlerësimit, i ndodhur në Sarandë; (ii) “truall/shesh ndërtimi” me sipërfaqe 367,8 m², në emër të ish-bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, i ndodhur në Sarandë; dhe (iii) “truall/shesh ndërtimi” me sipërfaqe 465 m², në emër të ish-bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, i ndodhur në Komunën Dropull i Poshtëm, Gjirokastër, lidhur me të cilët, Komisioni ka arritur në konkluzionin e përgjithshëm se: *trupi gjykues vëren një ndërthurje situatash faktiko-ligjore-administrative që janë pasojë dhe/ose kanë passjellë disa veprime apo mosveprime dhe përfitime të cilat – përpos mosdeklarimit të zotërimit të njërit truall, që subjekti vijonte ta kishte në zotërim totalisht prej vitit 2014, edhe në momentin e deklaratës vetting, çka përbën evidentimin e deklarimeve të pamjaftueshme si në deklaratat*

²⁸ Referuar paragrafit 58 të vendimit.

vjetore, ashtu edhe në atë vetting, fakt ky që dikton aplikimin e nenit D të Aneksit të Kushtetutës, si dhe të pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, për mosdeklarim/fshehje të pasurisë – në tërësinë e tyre, këto rrethana evidentojnë sjellje të subjektit në shkelje të etikës së gjyqtarit, të cilat kanë cenuar kësisoj edhe besimin e publikut në sistemin e drejtësisë, në kuptim të pikës 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

65. Nga arsyetimi i vendimit objekt kontrolli, trupi gjykues konstaton se këtë vlerësim të përgjithshëm, Komisioni e ka bërë pasi fillimisht ka arritur në konkluzionin se: *në vlerësim tërësor të fakteve, gërshetuar kjo me dinamikën e ngjarjeve të cituara nga subjekti i rivlerësimit – por të paqartësuara mbi mënyrën e përfitimit të pasurive “truall” disa vite më vonë nga subjekti dhe familja e saj – arrihet në konkluzionin se familja e subjektit të rivlerësimit ka përfitur në mënyrë të dyshimtë njëkohësisht tri sheshe të ndërtimit, pa plotësuar kriteret përkatëse dhe pa ndërmarrë prej saj ndonjë veprim distancimi, duke pranuar përfitimin e padrejtë, madje pa e deklaruar përfitimin e njërit prej shesheve as në deklaratat vjetore dhe as në atë vetting – siç do të arsyetohet në mënyrë të përmbledhur mbi të tria trojet e përfituara në raport me pozicionin dhe përfshirjen e subjektit të rivlerësimit, në vijim pasurisë nr. 3. Në vijim, Komisioni, për pasurisë nr. 3 – shesh ndërtimi me sipërfaqe 465 m², në emër të ish-bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, i ndodhur në Komunën Dropull i Poshtëm, ka arritur në konkluzionin se: *subjekti i rivlerësimit, duke mos deklaruar pasurinë në fjalë në deklaratën vetting, i është shmangur me vetëdije njëkohësisht kontrollit dhe verifikimit të ligjshmërisë së veprimeve të kryera – duke marrë në konsideratë edhe kryerjen e pagesës për lejen e ndërtimit në lidhje me truallin për investimin mbi këtë pasuri – edhe pse ndërtim i papërfunduar. Trupi gjykues i Komisionit vlerëson se subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e germës “c” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.**
66. Subjekti i rivlerësimit, shkakun e ankimit lidhur me këto pasuri, e ka bazuar në pretendimet se: (i) Në lidhje me truallin 400 m², konkluzioni i Komisionit se pasuria është përfitur në mënyrë të dyshimtë është i paarsyetuar, dhe Komisioni nuk tregon bazën ligjore ku mbështetet ky konkluzion. Kjo pasuri, dhënë në emër të saj mbi bazën e vendimit të Këshillit Bashkiak Sarandë nr. {***}, datë 28.08.1999, nuk ka kaluar asnjëherë në pronësi të saj, pasi nuk është kryer kalimi i pronësisë nga shitësi te blerësi dhe, megjithëse është miratuar e drejta për ndërtim mbi truallin dhe është paguar çmimi për blerjen e tij, kjo pasuri figuron akoma në gjendjen juridike “shtet”. (ii) Familja ka përfitur me procedura të rregullta dy sheshe ndërtimi më vete në Sarandë, por asnjëherë ajo apo ish-bashkëshorti nuk kanë përfitur pronësinë mbi këto troje. Çdo përfitim është kryer në mënyrë të ligjshme me burime të ligjshme, para fillimit të detyrës së saj si gjyqtare dhe është trajtuar njëllor me të gjithë qytetarët e tjerë. (iii) Subjekti pretendoi se marrëveshja për ndarje pasurie midis dy bashkëshortëve, e datës 06.02.2014, është një marrëveshje private për ndarjen e dy pasurive që ata zotëronin realisht, një zyrë dhe një kullotë në Kakavijë, por është e pavlefshme për pasuritë jo në pronësi të tyre. (iv) Subjekti ngre të njëjtat pretendime edhe sa i takon truallit me sipërfaqe 367,8 m², dhënë me vendim të Këshillit Bashkiak Sarandë, në emër të ish-bashkëshortit, si dhe për truallin me sipërfaqe 456 m², në Komunën Dropull i Poshtëm, dhënë në

emër të ish-bashkëshortit, duke pretenduar se ata janë aktualisht të pazhvilluar dhe nuk posedohen as *de facto* nga ajo apo ish-bashkëshorti.

67. Lidhur me këtë shkak ankimi, trupi gjykues, pasi shqyrtoi aktet e fashikullit të çështjes dhe kontrolloi arsyetimin e vendimit të Komisionit mbi bazën e pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, konstatoi dhe vlerësoi si më poshtë.
68. Në lidhje me sheshin e ndërtimit me sipërfaqe 400 m², ndodhur në Sarandë, rezulton se në deklaratën *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Shesh ndërtimi, miratuar me vendim të Këshillit Bashkiak Sarandë nr. {***}, datë 28.08.1999. Pa kontratë shitblerje, e paregjistruar pranë ZVRPP, vlera 192.384 lekë.* Në DIPP-në e vitit 2014, subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar këtë pasuri të përfituar me anë të deklaratës noteriale (marrëveshje për ndarjen e pasurisë bashkëshortore) nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 06.02.2014, në të cilën subjekti dhe ish-bashkëshorti i saj kanë rënë dakord që pasuria në fjalë të kalojë në pronësi të subjektit të rivlerësimit.
69. Gjatë hetimit administrativ, Komisioni, nëpërmjet pyetësorit nr. 2, i kërkoi subjektit të rivlerësimit shpjegime lidhur me mosdeklarimin e kësaj pasurie në vitin 2003. Në përgjigje të sa më sipër, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se: *Mosdeklarimi në vitin 2003 ka të bëjë thjesht me faktin se nuk e kisha kuptuar drejt mënyrën e plotësimit të deklaratës, prandaj e kam shtuar në deklaratën e vitit 2004. Kam menduar se duheshin deklaruar vetëm të ardhurat e vitit 2003.* Subjekti ka shtuar gjithashtu se në këtë pasuri nuk është kryer asnjë investim, as prej saj dhe as nga ish-bashkëshorti. Rezulton se në DIPP-në e vitit 2004, subjekti ka deklaruar truall me sipërfaqe 400 m², përfituar nga ish-bashkëshorti si i pastrehë me vendim të Këshillit Bashkiak Sarandë, me vlerë 200.000 lekë, ndërkohë që nga dokumentacioni i administruar nga Komisioni, ka rezultuar se subjekti dhe ish-bashkëshorti i saj kanë përfituar me të njëjtin vendim të Këshillit Bashkiak Sarandë nga një shesh ndërtimi secili, përkatësisht shesh ndërtimi me sipërfaqe 400 m², në emër të subjektit të rivlerësimit dhe shesh ndërtimi me sipërfaqe 367,8 m², në emër të ish-bashkëshortit të saj, të cilat, pas zgjidhjes së martesës, janë ndarë mes tyre dhe konkretisht subjekti ka marrë sheshin e ndërtimit të përfituar prej saj, me sipërfaqe 400 m², ndërsa ish-bashkëshorti sheshin e ndërtimit me sipërfaqe 367,8 m².
70. Në lidhje me këtë pasuri, Komisioni ka administruar dokumentacionin ligjor si vijon: (i) vendim i Këshillit Bashkiak Sarandë nr. {***}, datë 28.08.1999, sipas të cilit rezulton se subjektit të rivlerësimit, znj. M. K., i është dhënë në cilësinë e investitores *shesh ndërtimi*, blloku {***}, parcela nr. {***}, me sipërfaqe 400 m²; (ii) procesverbal i datës 18.01.2002, mbi piketimin e parcelës {***} shtesë, nr. {***} nga Zyra e Urbanistikës së Bashkisë Sarandë; (iii) mandatpagesë e datës 15.03.2002, për pagesën e truallit, në vlerën 192.384 lekë, paguar nga subjekti i rivlerësimit, znj. M. K., në favor të Bashkisë Sarandë; (iv) planimetri e sheshit të ndërtimit të objektit “Banesa nr. {***}”, në shtesën e kurorës së qytetit, të miratuar me vendim të Këshillit të Rregullimit të Territorit Sarandë nr. {***}, datë 09.04.2000, me sipërfaqe të përgjithshme 400 m², sipërfaqe ndërtimi 200 m² dhe numri i kateve 2-3.

71. ASHK Sarandë, me shkresën nr. {***} prot., datë 25.01.2021, ka informuar Komisionin se nuk ka rezultuar ndonjë pasuri e paluajtshme, e regjistruar në emër të subjektit të rivlerësimit, znj. M. K., si dhe nga verifikimi i sistemit elektronik të vetëdeklarimeve për legalizim, nuk ka rezultuar ndonjë aplikim për legalizimin e ndonjë pasurie informale. ASHK-ja ka sqaruar se për pasurinë në fjalë, shesh ndërtimi me sipërfaqe 400 m², miratuar me vendim të Këshillit Bashkiak Sarandë nr. {***}, datë 28.08.1999, parcela nr. {***}, nuk mund të japë informacion me këto të dhëna pasurie.
72. Në prapësimet ndaj rezultateve të hetimit, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se pasuria në fjalë nuk ka kaluar asnjëherë në pronësi të saj edhe pse për të është paguar çmimi i blerjes dhe është miratuar leja e ndërtimit. Sipas subjektit të rivlerësimit, për shkak të kalimit të afateve të parashikuara në nenin 29 të ligjit nr. 7693, datë 06.04.1993, “Për urbanistikën”, leja e ndërtimit dhe vendimi i Këshillit Bashkiak është bërë i pavlefshëm. Po ashtu, lidhur me truallin *shesh ndërtimi me sipërfaqe 367,8 m²*, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se nga familja e ish-bashkëshortit, në vitin 1993, ishte bërë kërkesë për të përfituar një shesh ndërtimi për plotësimin e nevojave familjare dhe se ai fillimisht kishte përfituar një shesh ndërtimi që në vitin 1995 me vendim të Këshillit Bashkiak, i cili është anuluar në tërësinë e tij me vendim gjykate për zonën Sarandë-Kanal i Cukës. Më pas, kjo zonë është trajtuar përsëri me VKM-në nr. 3, datë 25.8.1999, duke u bërë edhe rishpërndarja e shesheve tek qytetarët për këtë zonë.
73. Në analizë të sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se arsyetimi i Komisionit në drejtim të mënyrës së dyshimtë të përfitimit të këtyre dy trojeve si sheshe ndërtimi nga subjekti dhe ish-bashkëshorti është sipërfaqësor dhe nuk tregon se cilat janë ato veprime ose mosveprime të subjektit të rivlerësimit, të cilat kanë qenë në shkelje të parashikimeve ligjore dhe që i kanë siguruar përfitime të padrejta. Komisioni nuk ka identifikuar as ndonjë lidhje midis përfitimit të trojeve me ushtrimin nga subjekti i rivlerësimit të detyrës së gjyqtarit ose të ndonjë ndikimi të paligjshëm të saj te organet e pushtetit vendor që kanë kryer procedurat për dhënien e shesheve të ndërtimit. Për rrjedhojë, trupi gjykues vlerëson se konkluzioni i Komisionit lidhur me këto pasuri është i pabazuar në fakte dhe në ligj.
74. Në lidhje me sheshin e ndërtimit në Komunën Dropull i Poshtëm, Gjirokastër, me sipërfaqe 456 m², trupi gjykues konstaton se kjo pasuri është deklaruar për herë të parë nga subjekti i rivlerësimit në DIPP-në e vitit 2004, si pasuri e llojit *truall me sipërfaqe 600 m²*, ndodhur në Komunën Dropull i Poshtëm, përfituar nga ish-bashkëshorti i subjektit me anë të vendimit të Komunës Dropull nr. {***}, datë 28.02.2003 “Për miratimin e shesheve të ndërtimit”, me vlerë 200.000 lekë. Kjo pasuri është deklaruar nga subjekti i rivlerësimit edhe në DIPP-në e vitit 2014, së bashku me pasurinë 400 m², ndodhur në qytetin e Sarandës, të cilat, sipas deklaratës noteriale për ndarjen e pasurisë bashkëshortore nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 06.02.2014, i kanë kaluar subjektit të rivlerësimit. Në deklaratën *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar vetëm pasurinë *shesh ndërtimi me sipërfaqe 400 m²*, ndodhur në Sarandë, por nuk ka deklaruar sheshin e ndërtimit me sipërfaqe 456 m².

75. Gjatë hetimit administrativ, Komisioni ka kërkuar shpjegime nga subjekti i rivlerësimit lidhur me mosdeklarimin e kësaj pasurie në DIPP-në e vitit 2003, si dhe në deklaratën *vetting*. Subjekti i rivlerësimit, nëpërmjet përgjigjeve të pyetësorit nr. 2, ka shpjeguar se: *Mosdeklarimi në vitin 2003 ka të bëjë thjesht me faktin se nuk e kisha kuptuar drejt mënyrën e plotësimit të deklaratës, prandaj e kam shtuar në deklaratën e vitit 2004. Gjithashtu, nëpërmjet këtij pyetësi, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se: [...] pavarësisht se në deklaratën për ndarjen e pasurisë është shënuar një shesh në Komunën Dropull i Poshtëm, unë realisht nuk kam asnjë lloj pasurie në këtë komunë. Në nënshkrimin e deklaratës për shkak të rrethanave të zgjidhjes së martesës, nuk kam qenë e kujdesshme për detajet dhe e kam nënshkruar pa i dhënë rëndësi. Deklaroj përsëri se pasuritë reale për ndarje ishin 1 zyrë, të cilën e kam deklaruar, dhe 1 pasuri kullotë, e ndodhur në Kakavijë, të cilën e ka përfutuar ish-bashkëshorti. Për më tepër, unë nuk kam aplikuar kurrë për këtë truall në asnjë organ publik.*

76. Komisioni, me anë të shkresës nr. {***} prot., datë 23.11.2020, i ka kërkuar Bashkisë Dropull të vendosë në dispozicion dokumentacionin e plotë që i përket pasurisë *shesh ndërtimi* me sipërfaqe 456 m², dhënë ish-bashkëshortit të subjektit me Vendim të Këshillit Bashkiak Dropull nr. {***}, datë 28.03.2003. Në përgjigje të sa më sipër, Bashkia Dropull, me shkresën nr. {***} prot., datë 22.01.2021, ka vënë në dispozicion dosjen²⁹ e pasurisë me sipërfaqe 456 m², nga ku ka rezultuar se ish-bashkëshorti i subjektit, nëpërmjet Bankës së Kursimeve, në datën 21.07.2003, ka paguar shumën prej 68.136 lekësh, për blerjen e truallit në fjalë. Me anë të Vendimit të KRRT-së nr. {***}, datë 05.07.2007, ka rezultuar se ish-bashkëshortit të subjektit i është miratuar *“Leja për ndërtimin e objektit shesh depozitimi për materiale”* dhe në muajin dhjetor të vitit 2008, është përgatitur projekt-zbatimi i objektit *“Magazinë”*, si dhe është paguar shuma prej 26.700 lekësh, e barabartë me 1% të vlerës së investimit prej 2.670.000 lekësh, në favor të Komunës Dropull i Poshtëm. Komisioni, nëpërmjet pyetësorit nr. 2, i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit të shpjegojë arsyet e mospërputhjeve të konstatuara midis sipërfaqes së pasurisë dhe shumës së paguar për blerjen e truallit në vitin 2003, krahasuar me vlerat e deklaruara prej saj në DIPP-në e vitit 2004, si dhe të bëjë me dije lidhur me shpenzime të mundshme të ndërtimit të objektit *“magazinë”* mbi truallin në fjalë. Në përgjigje të sa më sipër, subjekti ka shpjeguar se: *“Vendi ku pretendohet trualli është origjina e babait tim dhe e ish-bashkëshortit tim, fshati Dhuvjan, Sofratikë, Komuna Dropull i Poshtëm, një fshat malor në emigrim ku jetojnë pesë familje. As unë, as familja ime nuk kemi*

²⁹ Kërkesë e shtetasit J. K., e datës 06.01.2003, drejtuar Komunës Dropull i Poshtëm, për pajisjen me shesh për tregtimin e materialeve të ndërtimit; vendim nr. {***}, datë 28.02.2003, *“Për miratimin e shesheve të ndërtimit”*, në pikën 4 është vendosur miratimin e sheshit për depozitim materiale me sipërfaqe 425 m², në favor të J. K.; kërkesë për miratimin e destinacionit dhe kondicioneve urbane të sheshit të ndërtimit nga J. K., datë 06.01.2003; pagesë për blerje trualli për llogari të Bashkisë Dropull i Poshtëm, derdhur nga J. K., në masën 68.136 lekë më datë 21.07.2003; vendim i Këshillit të Komunës për objektin shesh depozitimi e prodhimi për materiale ndërtimi, me sipërfaqe sheshi 456 m² dhe sipërfaqe ndërtimi 150 m²; kërkesë, datë 11.09.2006, për miratimin e lejes së ndërtimit; leje ndërtimi me vendim të KRRT nr. {***}, datë 05.07.2007; dy mandate arkëtimi përkatësisht me nr. {***}, datë 22.12.2008 dhe nr. {***}, datë 22.12.2008, me vlerë 26.700 lekë secila, në favor të Komunës Dropull i Poshtëm, për pagesën e shumës prej 1% të vlerës së preventivit prej 2.670.000 lekësh; preventiv punimesh për objektin *“magazinë në Dhuvjan”*, nënshkruar nga preventivues A. P., në shumën totale 1.935.850 lekë dhe planimetri e sheshit të ndërtimit.

*investuar asnjëherë për ndërtimin e ndonjë objekti. Gjithashtu dhe ish-bashkëshorti im e ka blerë këtë truall formalisht, por nuk ka investuar asnjëherë në të”. Së bashku me përgjigjet e mësipërme, subjekti ka paraqitur një vërtetim nga Bashkia Dropull nr. {***} prot, datë 04.03.2021, sipas të cilit, nga verifikimi në truallin objekt shqyrtimi, konstatohet se nuk është bërë ndërtimi, pavarësisht lejes së ndërtimit dhe pagesës së kryer në lidhje me këtë truall.*

77. Me qëllim qartësimin e statusit juridik të pronës objekt shqyrtimi, Komisioni i është drejtuar Bashkisë Dropull me shkresën nr. {***} prot., datë 01.04.2021, dhe shkresën nr. {***} prot., datë 05.05.2021. Në përgjigje, Bashkia Dropull, me shkresën nr. {***} prot., datë 14.05.2021, ka vënë në dispozicion të Komisionit dokumentacionin e përfitimit të këtij trualli, por pa informuar mbi statusin juridik të saj.
78. Në prapësime ndaj rezultateve të hetimit, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se, referuar edhe vërtetimit të Bashkisë Dropull, nuk është realizuar asnjë ndërtim mbi këtë sipërfaqe dhe konkluzioni i Komisionit se kjo pasuri nuk është deklaruar në deklaratën *vetting* dhe se subjekti ka kryer fshehje të pasurisë, është i padrejtë dhe i pabazuar në prova, pasi kjo sipërfaqe toke nuk është as juridikisht dhe as faktikisht në pronësi apo në zotërim të saj. Kjo pasuri nuk mund të deklarohej në deklaratën *vetting*, pasi nuk është përfituar në kuptim të ligjit dhe as është zhvilluar.
79. Bazuar në situatën faktike të analizuar më sipër, në kushtet kur nuk provohet kalimi i pronësisë mbi këtë truall nga pronari “shtet” te subjekti i rivlerësimit, trupi gjykues vlerëson se mosdeklarimi i këtij sheshi ndërtimi në deklaratën e pasurisë *vetting*, nuk përbën fshehje të pasurisë, në kuptim të nenit D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 33, pika 5, shkronja “c” e ligjit nr. 84/2016, por kjo situatë duhet të kualifikohet si deklarim i pasaktë, në kuptim të nenit 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016.
80. Në përfundim të analizës së mësipërme, trupi gjykues e gjen të pabazuar konkluzionin e Komisionit se me veprimet apo mosveprimet për përfitimin e këtyre trojeve si shesh ndërtimi dhe mënyrën e deklarimit të tyre në deklaratat periodike vjetore dhe në deklaratën *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë, në kuptim të nenit 61, pika 5 e ligjit nr.84/2016.
- Lidhur me pasurinë apartament banimi me sipërfaqe 98 m², në lagjen “{***}”, në Gjirokastër:
81. Subjekti i rivlerësimit kundërshton si të gabuar vlerësimin e Komisionit se ajo ka kryer fshehje të pasurisë apartament banimi me sip. 98 m², me vendndodhje në lagjen “{***}”, Gjirokastër.
82. Këtë vlerësim, Komisioni e ka bazuar në argumentet se: *Nuk ka ndonjë logjikë ekonomike dhe të qenësishme në investimin e prindërve të subjektit në këtë pasuri, për aq kohë sa kryerja e pagesës, referuar kontratës së porosisë, është bërë nga subjekti i rivlerësimit. Ndonëse në parashtrimet/prapësimet e sjella nga subjekti, u paraqitën tri mandatarkëtime të kryerjes së pagesave nga persona të tjerë, të cilat u depozituan vetëm në fazën përfundimtare dhe nuk u pretendua/përmend prezenca e tyre në asnjë fazë të hetimit si pagesa të kryera prej tyre, ndryshe*

dhe në kundërshtim nga sa përshkruhet në kontratën e porosisë të nënshkruar nga subjekti përpara një noteri publik. Për rrjedhojë, mandatet në fjalë nuk mund të zhbëjnë përmbajtjen e kontratës së firmosur nga subjekti dhe as mund të provojnë të kundërtën e saj, qoftë për forcën provuese, ashtu edhe për besueshmërinë dhe përputhjen e logjikshme dhe në harmoni me faktet e tjera dhe kontekstin specifik. Në këto kushte, mosdeklarimi i këtij veprimi juridik dhe financiar (kontrata e porosisë dhe pagesa përkatëse) gjen shkak dhe cilësohet si një tentativë për të shmangur veprimin juridik në fjalë në periudhën përkatëse dhe jo sepse nuk konsiderohej si një detyrim për t'u deklaruar, për faktin që apartamenti në fjalë nuk mund të përdorej nga prindërit e subjektit, apo që nuk mund të ishte si një investim prej tyre, për sa kohë nuk i dispononin mjetet e nevojshme monetare për të bërë një investim të tillë, dhe për faktin që prej një periudhe të gjatë kohore (e aktualisht) nuk jetonin në qytetin e Gjirokastrës. Në vijim e për rrjedhojë të sa më sipër, trupi gjykues krijon bindjen se, sikurse në momentin e porosisë, subjekti ka vepruar de jure dhe de facto në emrin e vet, duke e riparë pozicionin në funksion të pamundësisë që të justifikonte të ardhurat e ligjshme, duke vepruar me revokimin e kontratës së porosisë dhe duke e kaluar në emër të babait, këtë herë vetëm de jure, pasi de facto apartamenti vlerësohet të jetë ende i subjektit të rivlerësimit, pasi dyshimet e arsyeshme dhe logjika çojnë në konkluzionin se ajo ka kryer fshehje të pasurisë apartament banimi me sip. 98 m², me vendndodhje në Gjirokastrë.

83. Subjekti i rivlerësimit e ka bazuar shkakun e ankimit në pretendimet se: (i) ky apartament rezulton i regjistruar dhe është në pronësi të babait të saj; (ii) kontrata e blerjes së apartamentit është firmosur në emrin e babait të saj dhe se ajo nuk ka kryer asnjë pagesë për këtë pasuri; (iii) kjo pasuri nuk është deklaruar në DIPP-2014 pasi nuk është pasuri e saj dhe se kontrata e sipërmarrjes është nënshkruar në emrin e saj, pasi prokura e posaçme e lëshuar nga prindërit e saj nuk i lejonte tagra për të nënshkruar kontratën e porosisë në emër të tyre; (iv) vlera e porositjes apo blerjes së këtij apartamenti është shlyer sipas 3 mandatpagesave që vërtetojnë shumën e shlyer, kohën e kryerjes së pagesës, si dhe personin që e ka kryer atë; (v) Komisioni ka anashkaluar mandatpagesat e paraqitura prej saj, të cilat provojnë se për blerjen e kësaj pasurie nuk janë përdorur mjetet e saj financiare, por ato të prindërve të saj dhe se momenti i paraqitjes së tyre nuk zbeh fuqinë e tyre provuese; (vi) Komisioni nuk ka marrë parasysh se të ardhurat e prindërve nga pensioni janë të mjaftueshme për të mbuluar pothuajse gjithë investimin, si dhe nuk ka analizuar raportin e audituesit ligjor mbi të ardhurat e prindërve dhe provat e paraqitura prej saj, duke bërë që konkluzioni për pamjaftueshmëri të jetë tërësisht i pabazuar në fakte; (vii) megjithëse Komisioni paraprakisht ka vlerësuar se prindërit e saj kanë pasur të ardhura të ligjshme, në përfundim nuk i konsideron këto të ardhura, duke arritur në konkluzion të gabuar në lidhje me pronësinë e apartamentit objekt shqyrtimi; (viii) arsyetimi i Komisionit, sa i takon interesit të prindërve të subjektit për të investuar në Gjirokastrë, është plotësisht i gabuar.
84. Lidhur me këtë shkak ankimi, trupi gjykues, pasi shqyrtoi aktet e fashikullit të Komisionit në raport me arsyetimin e vendimit të Komisionit objekt kontrolli dhe pretendimet e subjektit të rivlerësimit lidhur me këtë pasuri, konstaton dhe vlerëson si më poshtë.

85. Nga hetimi administrativ i kryer nga Komisioni, rezultoi se në regjistrin noterial shqiptar është regjistruar një veprim i kryer nga subjekti i rivlerësimit në datën 04.03.2014, me përshkrimin: “Kontratë porosie”, pranë noterit B. Xh.. Komisioni, me shkresën nr. {***} prot., datë 05.10.2020, i ka kërkuar noterit B. Xh., kopje të kontratës së porosisë të nënshkruar nga subjekti i rivlerësimit me referencat nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 04.03.2014. Në kontratën e porosisë së përcjellë nga noteri, të lidhur ndërmjet subjektit të rivlerësimit, në cilësinë e palës porositëse, dhe shtetas L. K., në cilësinë e investitores, rezulton se palët kanë rënë dakord për ndërtimin e një apartamenti të ndodhur në katin e pestë të një banese masive në lagjen “{***}”, Gjirokastrë, me sipërfaqe 98 m², me çmim 4.500.000 lekë, nga të cilat, për sa deklarohet në këtë dokument, porositësja Mirela Iliopullo ka derdhur në datën 04.03.2014, për llogari të investitores L. K., shumën prej 4.200.000 lekësh dhe pjesa e mbetur ishte parashikuar të shlyhej deri në datën 10.09.2014.
86. Në vijim, Komisioni ka konstatuar se për të njëjtin apartament, kundrejt të njëjtit çmim, subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e përfaqësuesit të z. J. I., dhe investitorja L. K., kanë nënshkruar një tjetër kontratë porosie me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 20.12.2016.
87. Gjatë hetimit administrativ, nëpërmjet pyetësorit nr. 2, Komisioni e ka ftuar subjektin e rivlerësimit të japë shpjegime në lidhje me arsyen e mosdeklarimit të nënshkrimit të kontratës së porosisë dhe të kryerjes së pagesës në shumën 4.500.000 lekë në DIPP- 2014, duke i kërkuar të paraqesë dokumentacionin ligjor që provon kohën dhe mënyrën e kryerjes së pagesës/pagesave, si dhe burimin e ligjshëm të të ardhurave që kanë shërbyer për kryerjen e pagesës në fjalë. Në përgjigje të sa më sipër, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se: *Kontrata e porosisë së vitit 2014, ka qenë nënshkruar nga ana ime për llogari të babait tim, z. J. I., dhe për pasojë edhe pagesa e kryer ishte për llogari të babait tim dhe me para të dhëna nga babai im. Kjo kontratë është revokuar më datë 15.12.2016, me anë të dokumentit “Revokim kontratë porosie” nr. {***} rep., nr. {***} kol., pra unë në këtë rast kam funksionuar si ndërmjetëse ose ndihmëse për të përfunduar transaksionin, duke qenë se babai im nuk ndodhej në Shqipëri. Kjo është dhe arsyeja e mosdeklarimit të kontratës së porosisë dhe pagesës përkatëse, pra fakti se nuk kishim të bënim me pasuri timen dhe, për pasojë, nuk kisha çfarë të deklaroja në deklaratën time të pasurisë. Pagesat janë kryer me lekë në dorë dhe aktualisht nuk disponoj dokumentacion. Burimet e ligjshme të të ardhurave kanë qenë të ardhurat e babait tim, z. J. I., dhe mamasë sime, znj. V. I. Prindërit e mi kanë qenë mësues, kanë dalë në pension në moshë të re dhe janë larguar në emigracion që prej vitit 1992. Fillimisht kanë jetuar në Greqi, në qytetin e Korfuzit, dhe pas vitit 2010 janë larguar në ShBA, pasi babai im është shtetas amerikan, duke qenë se gjyshi im M. I. ka jetuar, punuar dhe vdekur në ShBA. Gjithashtu, prindërit e mi kanë shtetësi greke. Në Greqi, prindërit e mi kanë punuar që prej vitit 1992 deri në vitin kur janë larguar në ShBA. Dua të theksoj se prindërit e mi kanë pasur të ardhura nga trashëgimia e ardhur nga gjyshi im nga ShBA-ja rreth 45.000 USD, që e konvertuar është një shifër e konsiderueshme, shitja e një shtëpie në fshatin Dhuvjen, Gjirokastrë, si dhe kursime nga puna në emigracion. Gjithashtu, gjatë gjithë viteve të emigrimit, prej vitit 1992, të ardhurat nga pensionet e tyre kurseheshin pasi ata nuk jetonin në Shqipëri. Prindërit e mi gjatë viteve kanë pasur kursime dhe prokurat që paraqes, tregojnë se ata na jepnin të drejta për kryerjen e*

veprimeve në banka³⁰ në kohën që nuk mund të udhëtonin. Të ardhurat e tyre janë të mjaftueshme për blerjen e një apartamenti. Ata edhe në momentin e punësimit të tyre kanë pasur paga të larta për kohën dhe pjesa e trashëgimisë, por edhe kursime të tjera, është mbartur prej tyre në vite. Në mbështetje të këtyre deklarimeve, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur dokumentacionin mbi të ardhurat e prindërve të saj³¹. Së bashku me përgjigjet e mësipërme, subjekti i rivlerësimit ka depozituar në cilësinë e provës aktin noterial revokim kontrate porosie me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 15.12.2016, të nënshkruar ndërmjet saj dhe investitores L. K..

88. Komisioni, nëpërmjet pyetësorit nr. 3, i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit të japë shpjegime edhe sa i takon përdorimit të këtij apartamenti. Në përgjigje të kësaj kërkesë, subjekti ka sqaruar se në këtë apartament banon mbesa e saj me bashkëshortin, por nuk disponojnë ndonjë kontratë.
89. Për këtë pasuri është nënshkruar kontrata e shitblerjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 16.03.2018, e konfirmuar nga ASHK Gjirokastër, me shkresën nr. {***} prot., datë 27.02.2020³², e cila ka informuar se në emër të babait të subjektit të rivlerësimit, z. J. I., figuron e regjistruar pasuria me nr. {***}, e llojit apartament, me sipërfaqe 98 m², e blerë me anë të kontratës së shitblerjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 16.03.2018.
90. Nga shqyrtimi i DIPP-2014, Komisioni ka konstatuar se subjekti nuk ka deklaruar kryerjen e veprimit juridik të nënshkrimit të kontratës së porosisë dhe kryerjen e shpenzimit përkatës të

³⁰ Nga dokumentacioni i administruar nga Komisioni, ka rezultuar se në datën 21.07.2016, me anë të një prokure, subjekti i rivlerësimit ka tërhequr shumën prej 10.100 eurosh nga llogaria e babait të saj në Raiffeisen Bank. Komisioni i ka kërkuar subjektit të vinte në dispozicion prokurën e sipërcituar, si dhe të bënte me dije nëse kjo shumë ishte përdorur prej saj dhe për çfarë qëllimi. Subjekti, në përgjigje të pyetësorit, ka paraqitur prokurën e posaçme të datës 17.06.2016, përpara noterit publik të shtetit Massachusetts, ShBA, të prindërve të saj, të cilët e kanë autorizuar për të tërhequr shumën në depozitat e tyre në Alpha Bank dhe Raiffeisen Bank, si dhe ka sqaruar se kjo shumë nuk është përdorur prej saj për krijimin e ndonjë pasurie, por u është dhënë prindërve në momentin e ardhjes në Shqipëri. Arsyeja e tërheqjes ishte për shkak të lajmeve për krizë në sistemin bankar; prindërit patën frikë të linin paratë në bankat shqiptare dhe kanë kërkuar t'i tërhiqte dhe t'i ruante në banesën e saj.

³¹(i) Vërtetim nr. {***} prot., datë 26.02.2021, nga ISSH Gjirokastër për të ardhurat nga pensionet e pleqërisë së prindërve; (ii) deklaratë nga V. D., e cila ka deklaruar se prindërit e subjektit i kanë shitur shtëpinë e ndodhur në fshatin Dhuvjan, Gjirokastër, në vitin 1990, kundrejt shumës 200.000 lekë; (iii) praktika e trashëgimisë së lënë nga gjyshi i subjektit, sipas së cilës më 16.03.1970, shuma prej 23.508,10 USD, e ardhur në favor të trashëgimtarëve të të ndjerit M. E., është ndarë mes 4 trashëgimtarëve, nga të cilat pjesa takuese e babait të subjektit J. I., ka qenë 5.224,03 USD. Nga kjo shumë është zbritur 5% komisioni i shoqërisë komisionare dhe shpenzimet në masën 335 lekë; (iv) prokurë nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 11.11.2010, e lëshuar nga prindërit e subjektit, të cilët kanë caktuar dy vajzat e tyre, mes të cilave dhe subjekti, për të tërhequr pensionet e tyre të pleqërisë; (v) prokurë në gjuhën greke (përkthyer në shqip), me nr. {***}, e datës 11.05.2012, lëshuar në Greqi, nga prindërit e subjektit, me anë të së cilës kanë autorizuar subjektin që të tërheqë nga llogaritë e tyre bankare apo pensionin mujor të tyre; (vi) prokurë e posaçme e datës 13.01.2021, përpara noterit publik, në ShBA, e prindërve të subjektit, të cilët kanë autorizuar shtetasin Th. P., për të kërkuar informacion mbi llogaritë e tyre bankare në bankat greke; si dhe (vii) printim i një libeze kursimesh në emër të nënës së subjektit, në Bankën e Qipros, sipas së cilës është depozituar një shumë prej 20.000 eurosh në datën 05.11.2010 dhe tërhequr në datën 06.05.2011.

³² Në përgjigje të kërkesës së Komisionit me nr. {***} prot., datë 27.01.2020.

pagesës prej 4.200.000 lekësh për porositjen e apartamentit të sipërcituar. Gjithashtu, nga hetimi administrativ, si dhe referuar dokumentacionit të përcjellë nga subjekti, nuk ka rezultuar dokumentacion provues për dërgimin e parave nga prindërit e subjektit të rivlerësimit dhe as ndonjë dokument i kohës që të provojë porositjen e këtij apartamenti për llogari të tyre. Në këto kushte, Komisioni ka kryer analizën financiare për verifikimin e mundësinë financiare të subjektit për blerjen e kësaj pasurie me të ardhurat e saj deri në datën 4.3.2014, nga ku ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ishte në kushtet e pamjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme financiare për krijimin e kësaj pasurie.

91. Në përfundim të hetimit administrativ, me njoftimin e rezultateve të hetimit, Komisioni i kaloi barrën e provës subjektit për sa: *duket se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në DIPP-në e vitit 2014 këtë pasuri, veprimin juridik të kryer prej saj, si dhe shpenzimin përkatës për kryerjen e pagesës prej 4.200.000 lekësh, duke e fshehur atë. Duket se subjekti i rivlerësimit ka pasur një pamjaftueshmëri të burimeve të ligjshme financiare për të gjithë vlerën e blerjes së kësaj pasurie prej 4.200.000 lekësh.*
92. Në prapësimet ndaj rezultateve të hetimit, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se apartamenti në fjalë rezulton të jetë në emër të babait të saj dhe është në pronësi të tij, fakt ky që do të mjaftonte për të konkluduar në lidhje me pronësinë. Kontrata e blerjes së apartamentit është firmosur në emër të babait dhe nuk mund të konkludohet se apartamenti është pronë e saj vetëm duke u bazuar në një kontratë porosie tashmë të revokuar dhe, për pasojë, pa efekte juridike, dhe se mosdeklarimi në DIPP-2014 ka ardhur për faktin se kjo pasuri nuk është e saj. Për të provuar pretendimet e saj, subjekti i rivlerësimit, znj. Mirela Iliopullo, ka vënë në dispozicion të Komisionit tri mandatar-këtime³³, me të cilat pretendon të provojë se apartamenti objekt shqyrtimi nuk është në pronësi të saj dhe se për pagesat e kryera në lidhje me këtë pasuri, nuk janë përdorur mjetet e saj monetare.
93. Në analizë të fakteve dhe provave të parashtruara me lart, trupi gjykues konstaton se, referuar kontratës së porosisë nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 04.03.2014, subjekti i rivlerësimit kishte krijuar një marrëdhënie juridiko-civile me objekt prenotimin e një apartamenti me çmim 4.500.000 lekë, duke pranuar si të paguar në të njëjtën datë, 04.03.2014, në favor të znj. L. K. shumën prej 4.200.000 lekësh, ndërsa pjesa tjetër e çmimit është dakordësuar se do të paguhej më datë 10 shtator 2014, ditën e lidhjes së kontratës së shitjes. Sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit kishte detyrimin për deklarimin e kontratës së prenotimit pranë ILDKPKI-së në vitin 2014, në rubrikën “Detyrime financiare ndaj personave juridikë dhe fizike”, si dhe në rubrikën “Shpenzime të deklarueshme” dhe pretendimi i subjektit se nuk e ka deklaruar këtë veprim juridik lidhur me pasurinë objekt kontrolli pasi ajo nuk është e saj, por është pasuri e babait të saj, është në kundërshtim me përmbajtjen e kontratës së porosisë.

³³ Mandati i muajit maj të vitit 2013, në shumën 20.000 USD, paguar nga babai J. I.; mandati i muajit shkurt të vitit 2014, në shumën 2.100.000 lekë, si dhe mandati i muajit shkurt të vitit 2018, në shumën 300.000 lekë, paguar nga bashkëshorti i motrës, z. A. G., për llogari të babait të subjektit.

94. Sa i takon pretendimit të subjektit se apartamenti është regjistruar në pronësi të babait të saj dhe se nuk mund të konkludohet në lidhje me pronësinë e këtij apartamenti duke u bazuar vetëm në një kontratë porosie, e cila tashmë është revokuar, trupi gjykues konstatoi se, gjatë hetimit administrativ, subjekti ka pretenduar se kontrata e porosisë e vitit 2014 është revokuar më datë 15.12.2016, sipas aktit noterial “Revokim kontrate” nr. {***}, datë 15.12.2016, të paraqitur prej saj në cilësinë e provës. Në këtë akt rezulton se palët, duke iu referuar kontratës së porosisë nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 04.03.2014, kanë deklaruar se: *Pavarësisht se kontrata është lidhur në emër të subjektit të rivlerësimit, ajo ka vepruar me autorizim të babait të saj, z. J. I., dhe apartamenti është porosi e tij, paratë i ka dhënë ai dhe se në kushtet kur ai vetë, sipas deklaratës noteriale të datës 20.10.2016 para noterit publik, në shtetin Massachusetts, USA, ka autorizuar vajzën e tij Mirela Kore (Iliopullo) që të kryejë çdo veprim mbi një pasuri të paluajtshme, kontratë porosie, si dhe është shprehur se çdo veprim tjetër i kryer prej saj konsiderohet se është kryer për llogarinë tij dhe me aprovimin e tij, palët kanë rënë dakord mes tyre për revokimin e kontratës së porosisë së vitit 2014 dhe, me revokimin e saj, janë shprehur se kthehen në gjendjen e mëparshme pa asnjë detyrim financiar dhe asnjë detyrim ndaj njëra-tjetrës.*
95. Referuar akteve të administruara gjatë hetimit administrativ në Komision, trupi gjykues konstaton se, në vijim të aktit noterial “Revokim kontrate”, për të njëjtin apartament, mes subjektit të rivlerësimit, në cilësinë e përfaqësueses me prokurë të posaçme të babait të saj³⁴, dhe znj. L. K. është nënshkruar një tjetër kontratë porosie nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 20.12.2016, ku palët kanë rënë dakord për porositjen e të njëjtit apartament, me të njëjtin çmim prej 4.500.000 lekësh, duke e konsideruar të paguar nga porositësi në favor të investitorit shumë 4.200.000 lekë, ndërkohë që pjesa tjetër e çmimit prej 300.000 lekësh do të shlyhej ditën e lidhjes së kontratës së shitjes.
96. Ndërkohë, në kundërshtim me sa ka deklaruar dhe firmosur para noterit publik, dhe deklaruar prej saj gjatë hetimit administrativ³⁵, pas rezultateve të hetimit, subjekti ka pretenduar se pagesat janë shlyer nga vetë babai i saj dhe persona të tjerë për llogari të tij, dhe për të provuar këtë pretendim ka paraqitur tri mandatpagesat: (i) mandati i parë në muajin maj 2013, në shumën 20.000 USD (njëzet mijë dollarë), paguar nga vetë J. I.; (ii) mandati i dytë në shumën 2.100.000 lekë, paguar në muajin shkurt 2014 nga z. A. G.³⁶ për llogari të vjehrrit; (iii) mandati i tretë në shumën 300.000 lekë, paguar në muajin shkurt 2018 nga z. A. G. për llogari të vjehrrit.
97. Nga analizimi i përmbajtjes së këtyre mandatpagesave, rezultoi se mandati i parë i muajit maj 2013 paraqet shumën 20.000 USD, të paguar si këst nga vetë babai i subjektit të rivlerësimit, pa

³⁴ Babai i subjektit të rivlerësimit, z. J. I., ka autorizuar Mirela Iliopullo, nëpërmjet prokurës së përgjithshme të datës 20.10.2016, të lëshuar në Worcester, MA, ShBA, për kryerjen e veprimeve ligjore dhe administrative bankare për blerje dhe shitje të pasurive të luajtshme apo të paluajtshme në emër të tij.

³⁵ Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “Pagesat janë kryer me lekë në dorë dhe aktualisht nuk disponoj dokumentacion”.

³⁶ Bashkëshorti i motrës së subjektit të rivlerësimit.

përcaktuar destinacionin, objektin, kontratën e porosisë/sipërmarrjes apo marrëveshjen sipas së cilës depozituesi paguan këtë shumë. Për më tepër, vihet re se ajo daton në muajin maj të vitit 2013, gati një vit para se subjekti i rivlerësimit të ketë nënshkruar kontratën e parë të porosisë, pa asnjë gjurmë të një marrëveshjeje me investitorin për porosinë e apartamentit objekt kontrolli. Pretendimi i subjektit të rivlerësimit se pagesa për apartamentin është bërë nga vetë babai i saj J. I.³⁷, u vlerësua nga trupi gjykues i pabesueshëm, pasi nuk mund të pranohet që babai i saj në vitin 2013 ka kryer një pagesë në shumën 20.000 USD në favor të një investitori, në mungesë të një kontrate të shkruar, ndërkohë që duke qenë vetë prezent, mbetet e pashpjegueshme arsyeja se përse nuk ka nënshkruar një kontratë porosie apo aktmarrëveshje për të garantuar nga pikëpamja ligjore pagesën e kryer apo, në rrethana të cilat pamundësonin sa më sipër, së paku të kishte lëshuar një prokurë për subjektin e rivlerësimit (të bijën) për ta autorizuar atë, paraprakisht dhe jo *post factum*, për vijimin e të gjitha procedurave për nënshkrimin e kontratës së porosisë, kryerjen e pagesave dhe realizimin e kontratës së shitjes, sikurse pretendohet se ka bërë më vonë në vitin 2016³⁸. Për sa më sipër, pretendimet dhe shpjegimet e subjektit të rivlerësimit se i ati, në muajin maj 2013 ka shlyer vetë shumën 20.000 USD për apartamentin objekt shqyrtimi, jo vetëm bie ndesh me deklarin sipas kontratës së porosisë, por është edhe në kontradiktë me sa vetë subjekti ka deklaruar e shpjeguar gjatë hetimit administrativ.

98. Sa i takon mandatarkëtimin të dytë, i cili pretendohet të jetë shlyer në muajin shkurt 2014 nga bashkëshorti i motrës së subjektit për llogari të babit të saj, trupi gjykues vëren se, edhe pse ky mandat në dukje është i afërt në kohë me kohën e nënshkrimit të kontratës së porosisë në vitin 2014, vlerësohet se bie ndesh me sa subjekti ka deklaruar në kontratën e porosisë para noterit publik, ku çmimi deklarohet i shlyer pjesërisht në shumën 4.200.000 lekë në datën 04.03.2014. Në vlerësim të sa më sipër, trupi gjykues çmon se deklarinimet e subjektit të rivlerësimit para noterit publik kanë vlerë më të lartë provuese në raport me mandatpagesat të cilat janë shkresa të thjeshta private, dhe janë paraqitur nga subjekti në një fazë të avancuar të procesit të rivlerësimit dhe pasi kishte deklaruar më parë gjatë hetimit administrativ se nuk dispononte dokumentacion provues në lidhje me pagesat e kryera për këtë apartament. Mandati i tretë, në shumën 300.000 lekë, pretendohet të jetë paguar në muajin shkurt 2018 dhe, për rrjedhojë, nuk paraqet rëndësi në raport me analizën e mësipërme.
99. Në përfundim të kësaj analize, të bazuar mbi situatën faktike të provuar nga provat e administruara gjatë hetimit administrativ të Komisionit, trupi gjykues krijoi bindjen se porositësi i apartamentit

³⁷ Në prapësimet e rezultateve të hetimit, subjekti është shprehur: “Vlera e porositjes apo blerjes së këtij apartamenti është shlyer sipas 3 (tri) mandate që vërtetojnë se pagesat në lidhje me këtë apartament janë kryer si më poshtë: mandati i parë në muajin maj 2013, në shumën 20.000 USD (njëzet mijë dollarë amerikanë), paguar nga vetë babai im J. I.”. Po ashtu edhe në ankim, f. 29, shprehet se mandati i parë në shumën 20.000 USD është paguar nga vetë babai Jorgji Iliopullo.

³⁸ Nëpërmjet prokurës së përgjithshme të datës 20.10.2016, të lëshuar në Worcester, MA, ShBA, për kryerjen e veprimeve ligjore dhe administrative bankare për blerje dhe shitje të pasurive të luajtshme apo të paluajtshme në emër të tij.

të banimit 98 m² dhe pronari i tij nuk është babai i subjektit, por vetë subjekti i rivlerësimit, i cili ka pasur qëllim të porosisë dhe të blejë këtë apartament që në vitin 2014, qëllim të cilin e ka formalizuar nëpërmjet kontratës së porosisë me investitorin L. K., duke i paguar asaj 93,3% të vlerës së apartamentit, pavarësisht se kontrata e shitblerjes e realizuar në vitin 2018, është lidhur në emër të babait të subjektit. Veprimet noteriale të kryera nga subjekti i rivlerësimit në muajin dhjetor 2016 për revokimin e kontratës së porosisë, duke e rilidhur atë në emër të babait pak kohë para plotësimit dhe dorëzimit të deklaratës *vetting*, nuk justifikojnë pretendimin e saj se ajo nuk është pronarja reale e kësaj pasurie.

100. Përfundimisht, trupi gjykues vlerëson se lidhur me pasurinë apartament banimi me sipërfaqe 98 m², ndodhur në lagjen “{***}”, Gjirokastër, subjekti i rivlerësimit ka kryer fshehje të pasurisë, duke u gjendur në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronja “c” e ligjit nr. 84/2016.

➤ Lidhur me shpenzimet e vajzës së subjektit të rivlerësimit në ShBA:

101. Subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar si të gabuar nëpërmjet ankimit konkluzionin e Komisionit se: *lidhur me burimin e ligjshëm për kryerjen e shpenzimeve të jetesës dhe të studimit në ShBA të vajzës së subjektit të rivlerësimit, në mungesë të burimeve alternative, për sa kohë pretendimet e subjektit mbetën të paprovuara, përfundimisht trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit dhe familja e tij kanë pasur mungesë të burimeve të ligjshme financiare, së paku në masën 3.750.154 lekë dhe për sa kohë nuk janë deklaruar as kryerja e as burimet e përdorura për këto shpenzime, subjekti ka kryer deklarime të pamjaftueshme dhe të paplota në vitet përkatëse, duke shmangur kontrollin e tyre nga organet kompetente.*

102. Këtë shkak ankimi, subjekti i rivlerësimit e ka bazuar në pretendimet se: (i) këto shpenzime nuk janë kryer prej saj dhe, për pasojë, nuk janë shpenzime të deklarueshme dhe se, edhe sikur të ketë pasaktësi në deklaratat periodike vjetore, bazuar në jurisprudencën e Kolegjit, këto pasaktësi nuk mund të përbëjnë shkak për dhënien e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra; (ii) Komisioni nuk ka kryer analizë financiare për përlllogaritjen e shpenzimeve për qëndrimin e vajzës në ShBA, por u është referuar burimeve nga interneti; (iii) gjatë hetimit ka paraqitur disa mandate transfertash nga babai i të fejuarit të vajzës drejt të birit me qëllim evidentimin e dërgimit të parave drejt ShBA-së, por nuk janë paraqitur dokumente të tjera për shkak se nga ana e Komisionit, nuk u krye analizë financiare për këtë qëllim; (iv) analiza financiare në lidhje me shpenzimet e vajzës së saj në ShBA, duhet të kryhet nga Kolegji, i cili duhet të marrë në konsideratë edhe dokumentet e paraqitura prej saj bashkëlidhur ankimit, të cilat evidentojnë të gjitha transfertat e kryera nga babai i të fejuarit të vajzës drejt ShBA-së; (v) gjatë hetimit në Komision, si dhe nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur prej saj bashkëlidhur ankimit, dokumentohen të ardhurat e vjehrrit të vajzës që vërtetojnë burimin e ligjshëm të pagesave të kryera nëpërmjet sistemit bankar në favor të djalit të tij dhe se, në kushtet kur transfertat janë kryer nëpërmjet sistemit bankar, për më tepër drejt ShBA-së, atëherë ato e kanë kaluar testin e burimit të ligjshëm; (vi) nuk ka detyrimin që të provojë ligjshmërinë e të ardhurave të vjehrrit të vajzës pasi ligji e lidh detyrimin për të justifikuar

ligjshmërinë e burimit të të ardhurave të personave të tjerë të lidhur, vetëm me dhurimin apo krijimin e një pasurie, ndërsa i fejuari i vajzës dhe babai i tij nuk kualifikohen person tjetër i lidhur, pasi mbulimi i shpenzimeve të jetesës nuk është dhurim dhe nuk ka shërbyer për krijimin e ndonjë pasurie.

103. Trupi gjykues, pasi shqyrtoi aktet e fashikullit të Komisionit dhe kontrolloi vendimin objekt ankimi mbi bazën e pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, konstatoi dhe vlerësoi si më poshtë.
104. Komisioni, vlerësimin e kundërshtuar nga subjekti, e ka bazuar në arsyetimin se: *Trupi gjykues, nisur nga pretendimet, argumentimet dhe dokumentacioni i paraqitur nga subjekti, i vlerëson ato jobindëse dhe shteruese lidhur me burimet e ligjshme që mund të jenë përdorur prej personave të tretë për përballimin e shpenzimeve jetike dhe të shkollimit të vajzës së saj në ShBA. Ndërkohë që as vetë familja e subjektit nuk ka pasur mjaftueshmëri të mjeteve financiare për të financuar shpenzimet e vajzës së tyre – fakt ky që as nuk është pretenduar nga subjekti, për sa kohë është shprehur se nuk ka shpenzuar asgjë për të bijën pas largimit të saj në ShBA. Gjithashtu, edhe nga analizimi i provave të paraqitura, vlerëson se subjekti i rivlerësimit dhe vajza e saj si person i lidhur, që mbart detyrimin për deklaram sipas ligjit, nuk kanë deklaruar në DIPPV-të e viteve 2012-2016 as shpenzimet dhe as dhurimet e pretenduara si të përfituara për mbulimin e shpenzimeve të jetesës dhe të shkollimit në ShBA. Nga ana tjetër, trupi gjykues vlerëson se jo vetëm që nuk është provuar mjaftueshmëria e mjeteve financiare me burim të ligjshëm të përdorura për shpenzimet jetike dhe të shkollimit të vajzës së subjektit, por shpjegimi i dhënë së fundmi nuk duket bindës, për sa kohë rezulton pa sens logjik dhe pa një shkak të besueshëm fakti që shtetasi A. G. t'i dhurojë shtetasit R. B. – asokohe babai i të fejuarit të vajzës së subjektit – shumën prej 71.200 eurosh, për të përballuar shpenzimet e shkollimit të djalit dhe të fejuarës së tij. Për më tepër që kalimi i këtyre shumave në disponibilitetin e këtyre të fundit nuk është provuar. Ndërkohë që Komisioni, në përlllogaritjet e kryera, ka përfshirë të gjitha transfertat që shtetasi R. B. kishte transferuar në drejtim/favor të djalit të tij dhe ka rezultuar se të ardhurat e provuara me burim të ligjshëm nuk mjaftonin as për të përballuar shpenzimet e të fejuarit, duke mbetur pa burime të ligjshme mjetet monetare të përdorura nga/për vajza/ën e subjektit të rivlerësimit në ShBA.*
105. Gjatë hetimit administrativ të Komisionit, në përgjigje të pyetësorit nr. 1, subjekti ka deklaruar se nga viti 2012, vajza e saj është larguar në New Jersey, ShBA, ku ka vazhduar studimet, fillimisht në Bergen Community College dhe më pas në Fairleigh Dickinson University dhe se shpenzimet e jetesës së vajzës në ShBA, janë përballuar nga i fejuari i saj, z. D. B.. Në mbështetje të sa më sipër, subjekti ka paraqitur deklaratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 09.03.2021, të lëshuar nga ky i fundit, në të cilën ka deklaruar se prej vitit 2012 e në vijim, ka jetuar së bashku me të fejuarën e tij në ShBA dhe se ka mbuluar të gjitha shpenzimet për shkollimin dhe jetesën. Komisioni, nëpërmjet pyetësorëve nr. 2 dhe nr. 3, e ka ftuar subjektin të deklarojë shpenzimet e mundshme të shkollimit të vajzës në secilin prej institucioneve arsimore, si dhe shpenzimet e jetesës. Në përgjigje të sa më sipër, subjekti ka shpjeguar se studimet e së bijës në Bergen Community College janë përballuar nga ndihma financiare (të pakthyeshme) nga shteti amerikan,

duke qenë nënshtetase amerikane, si dhe ka përfituar rimbursim sipas rregullave standarde të ShBA-së. Për të provuar sa më sipër shpjeguar, subjekti ka paraqitur dokumentacion provues lidhur me pagesat konkrete, shpenzimet e shkollimit, ndihmën financiare të akorduar nga institucionet arsimore³⁹. Komisioni i ka kërkuar gjithashtu subjektit të sqarojë mbi burimin e ligjshëm të të ardhurave të të fejuarit të vajzës, z. D. B., i cili ka mundësuar mbulimin e shpenzimeve të shkollimit dhe të jetesës së saj në ShBA. Në përgjigje të sa më sipër, subjekti ka shpjeguar se burim i të ardhurave të tij kanë qenë dhurata nga i ati, z. R. B., të cilat janë transferuar nëpërmjet bankës ose Western Union-it. Për të provuar sa më sipër, subjekti ka paraqitur, së bashku me përgjigjet e mësipërme, disa transfertat bankare përgjatë periudhës shtator 2011 – maj 2013, të kryera nga z. R. B. në favor të djalit të tij, të cilat kanë rezultuar në shumën totale 31.350 USD (të konvertuara në 3.289.777 lekë). Nëpërmjet pyetësorit nr. 3, Komisioni i ka kërkuar gjithashtu subjektit të japë sqarime mbi burimin e ligjshëm të të ardhurave të babait të të fejuarit të vajzës së saj, që kanë mundësuar mbulimin e shpenzimeve. Në vijim të kësaj kërkesë, subjekti ka paraqitur së bashku me përgjigjet e saj, dokumentacion provues lidhur me të ardhurat e vjehrrit të vajzës⁴⁰. Subjekti ka paraqitur, së bashku me përgjigjet e pyetësorit nr. 3, deklaratat vjetore të të ardhurave të të fejuarit të vajzës, për periudhën 2015–2018, nga analizimi i të cilave ka rezultuar se të ardhurat e tij nga vetëpunësimi në ShBA, për periudhën në analizë, 2015 dhe 2016, kanë qenë 523.150 lekë⁴¹.

106. Komisioni ka marrë informacion në faqet zyrtare në internet të institucioneve statistikore në ShBA, për të përcaktuar nivelin e shpenzimeve të jetesës në ShBA. Nga kërkimet në web⁴²,

³⁹ Raport i detajuar mbi shpenzimet e shkollimit për secilin semestër të Bergen Community College, për shtetasen M. K., në të cilin janë evidentuar pagesat konkrete të kryera nga ndihma financiare, nga vetë studenti, si dhe rimbursimet e përfituara; kartela e llogarisë së studentit M. K. nga Fairleigh Dickinson University, në të cilën janë detajuar shpenzimet e shkollimit për secilin semestër, duke u evidentuar pagesat konkrete të kryera nga ndihma financiare dhe nga vetë studenti; vërtetim i datës 11.12.2019, lëshuar nga Fairleigh Dickinson University, në të cilin është konfirmuar se vajza e subjektit ka ndjekur studimet në këtë universitet, gjatë periudhës gusht 2015 – shkurt 2018 dhe gjatë kësaj kohe i është akorduar ndihmë financiare shtetërore dhe institucionale, në formën e granteve, bursave dhe kredive për të mbuluar shpenzimet.

⁴⁰ Deklaratë noteriale me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 16.04.2021, lëshuar nga shtetasi R. B., i cili ka deklaruar se të ardhurat nga shitja e truallit, nga qiradhënia e karburantit në Gjirokastër dhe transfertat e bërë nga shtetasi A. G. në vitin 2011, janë përdorur për financimin e djalit dhe familjes së tij në ShBA; kontratë shitblerjeje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 26.03.2003, për shitjen e një pasurie të paluajtshme të llojit “truall”, të shtetasit R. B., shoqërisë “{***}” SHPK, kundrejt çmimit 3.900.000 lekë; kontratë qiraje (e panoterizuar) e datës 01.05.2008, me afat 5-vjeçar, e lidhur midis qiradhënësit R. B. dhe qiramarrësit “{***}” SHPK, për dhënie me qira të pasurisë së paluajtshme me nr. {***}, kundrejt çmimit 100.000 lekë neto në muaj; kontratë qiraje (e panoterizuar) e datës 22.03.2013, me afat 5-vjeçar, e lidhur midis qiradhënësit R. B. dhe qiramarrësit “{***}” SHPK, për dhënie me qira të pasurisë së paluajtshme me nr. {***}, kundrejt çmimit 100.000 lekë neto në muaj; lëvizjet bankare të llogarisë në BKT të shtetasit R. B., sipas së cilës më datë 03.02.2011, janë transferuar në favor të tij nga shoqëria “{***}” SHPK, shuma prej 10.000.000 lekësh, me përshkrimin “ndihmë financiare”. Nga kjo shumë është kryer një pagesë prej 8.250.000 lekësh në favor të DRT Sarandë dhe shuma prej 1.400.000 lekësh është tërhequr cash.

⁴¹ Pas taksave, të cilat janë konsideruar të paguara në vitin pasardhës, pas plotësimit të deklaratave.

⁴² [cpsmar19.pdf \(census.gov\)](#)

Komisioni ka marrë në konsideratë shpenzimet e jetesës më të ulëta (niveli i varfërisë) për dy persona⁴³. Në përfundim të hetimit administrativ, Komisioni ka konsideruar si burim të ligjshëm rimbursimet e përfituara nga vajza e subjektit nga ndihma financiare për studimet, të cilat, nga dokumentacioni i administruar, kanë rezultuar në shumën ekuivalente prej 608.667 lekësh dhe ka shtuar në analizë edhe shumat e dërguara nga subjekti në llogari të vajzës në ShBA nga llogaritë e saj bankare, në shumën totale prej 822.408 lekësh. Komisioni ka konstatuar se transfertat e babait të të fejuarit të vajzës, z. R. B., me burime financiare të ligjshme, drejt djalit të tij D. B. në ShBA, kanë qenë të pamjaftueshme për përballimin e shpenzimeve të jetesës së djalit të tij për periudhën 2011-2016, të cilat Komisioni i ka llogaritur në shumën 9.957.070 lekë dhe, si rrjedhojë, ato nuk kanë shërbyer për përballimin e shpenzimeve të jetesës së vajzës së subjektit për të njëjtën periudhë, të cilat Komisioni i ka llogaritur në shumën 5.181.230 lekë. Në përfundim të analizës paraprake financiare, Komisioni ka arritur në konkluzionin se vajza e subjektit ka pasur pamjaftueshmëri të burimeve financiare të ligjshme për përballimin e shpenzimeve të jetesës dhe studimeve në ShBA, në shumën 3.750.154 lekë.

107. Komisioni i ka kaluar barrën e provës subjektit të rivlerësimit për sa duket se subjekti i rivlerësimit dhe vajza e saj nuk kanë deklaruar në DIPP-të e viteve 2012 – 2016, shpenzimet dhe as dhurimet e përfituara për mbulimin e shpenzimeve të jetesës dhe të shkollimit të kësaj të fundit në ShBA gjatë kësaj periudhe, dhe se vajza e subjektit të rivlerësimit ka pasur mungesë të burimeve të ligjshme financiare në masën 3.750.154 lekë, për të përballuar shpenzimet e jetesës dhe të studimeve në ShBA.
108. Në parashtrimet ndaj rezultateve të hetimit, subjekti i rivlerësimit u ka qëndruar të njëjtave pretendime që kishte paraqitur gjatë hetimit administrativ dhe për të provuar mundësinë financiare të të fejuarit të vajzës, subjekti ka vënë në dispozicion deklaratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 25.06.2021, të shtetasit A. G., si dhe të dhënat bankare të tij, ku deklarohet se ky i fundit, më datë 21.08.2009, ka depozituar në llogarinë bankare të z. R. B. në Alpha Bank Abania, shumën prej 71.200 USD, për qëllime të dhënies së ndihmës financiare, të cilën më pas ia ka dhuruar shtetasit R. B., vjehrrit të vajzës së subjektit, për të cilën subjekti i rivlerësimit pretendon se ka shërbyer si burim për mbulimin e shpenzimeve të vajzës.
109. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se shpenzimet e jetesës dhe të studimit të vajzës së saj në ShBA nuk janë shpenzime të deklarueshme, pasi nuk janë kryer prej saj, trupi gjykues, pasi verifikoi deklaratat periodike vjetore të subjektit, konstatoi se as subjekti i rivlerësimit dhe as vajza e saj (person i lidhur, madhor), në kundërshtim me detyrimin ligjor të parashikuar në nenin

⁴³ Duke qenë se shpenzimet e qirasë së vajzës së subjektit dhe të fejuarit të saj janë të dokumentuara, Komisioni ka zbritur nga shpenzimet totale vjetore të përcaktuara për nivelin e varfërisë në ShBA, duke shtuar shpenzimet konkrete të përballuara prej tyre për qiranë e banesës. Hapësirën që zënë shpenzimet e shtëpisë në shpenzimet totale të jetesës, për dy persona nën 65 vjeç, Komisioni e ka konsideruar në masën 27,3%, duke u bazuar në Anketën e Buxhetit të Familjes në Bergen, New Jersey, në linkun si vijon: <https://www.epi.org/publication/family-budget-calculator-documentation/>.

4, shkronja “h” e ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, i ndryshuar, nuk kanë deklaruar në formën e shpenzimit të deklarueshëm, shpenzimet e shkollimit dhe jetesës së vajzës në Shtetet e Bashkuara të Amerikës për periudhën 2012 - 2016, për rrjedhojë konstatimi i Komisionit në vendim për mosdeklarim në përputhje me ligjin, është i drejtë.

110. Lidhur me pretendimin e subjektit se Komisioni nuk ka kryer analizë financiare në lidhje me shpenzimet e përllogaritura për qëndrimin e vajzës në ShBA, por u është referuar disa burimeve nga interneti, dhe se në mungesë të kësaj analize nga subjekti, janë dorëzuar vetëm disa mandate me qëllim saktësimin e procesit të dërgimit të parave në ShBA, duke i kërkuar Kolegjit bërjen e një analize financiare bazuar edhe në dokumentacionin shtesë të paraqitur bashkë me ankimin, trupi gjykues konstatoi se Komisioni, për të përcaktuar nivelin e shpenzimeve të jetesës në ShBA, ka kryer kërkime në web, në faqet zyrtare të institucioneve statistikore në ShBA, dhe se bazuar në këto kërkime, duke marrë në konsideratë shpenzimet më të ulëta të jetesës për dy persona (në nivelin e varfërisë), nga përllogaritjet për periudhën 2011-2016, shpenzimet për jetesën dhe shkollimin e vajzës së subjektit dhe të jetesës për të fejuarin e saj, rezultojnë në masën totale 15.138.299 lekë, nga të cilat 9.957.070 lekë ka qenë pjesa takuese e të fejuarit dhe 5.181.230 lekë pjesa takuese e vajzës së subjektit. Në rezultatet e hetimit, subjektit të rivlerësimit i është njoftuar faqja e internetit nga ku burojnë të dhënat statistikore që kanë shërbyer për përllogaritjen e shpenzimeve të jetesës⁴⁴, gjithashtu është njoftuar në lidhje me të ardhurat me burime të ligjshme që Komisioni ka marrë në konsideratë në përllogaritjen e tyre. Nga kontrolli i ushtruar këtyre llogaritjeve të Komisionit nëpërmjet Njësisë së Shërbimit Ligjor, trupi gjykues konstatoi se shpenzimet për qëndrimin e vajzës së subjektit dhe të fejuarin e saj në ShBA, për periudhën 2011-2016, janë përllogaritur saktë nga Komisioni.
111. Lidhur me aktet bashkëlidhur ankimit, për të cilat subjekti kërkoi marrjen si prova të reja në gjykim: (i) katër mandate transfertash bankare të kryera pranë Raiffeisen Bank, dy prej të cilave rezultojnë në të njëjtën datë, 22.12.2010, dhe në shumën 7.000 USD (pra, për të njëjtën transfertë prej 7.000 USD), e cila rezulton të jetë kryer nga R. B., vjehri i vajzës së subjektit, me përshkrimin “Payment for school” (pagesë për shkollën), mandati i tretë, transfertë e datës 11.06.2013, në shumën 1.000 USD, me përshkrimin “Pagesë për qira”, e kryer nga shoqëria “{***}” ShPK, me përfitues D. B., dhe mandati i katërt, transfertë e datës 28.06.2013, në shumën 1.600 USD, me përshkrimin “Pagesë qiraje”, e kryer nga shoqëria “{***}” ShPK, me përfitues D. B.; (ii) lëvizjet e llogarisë bankare të shoqërisë “{***}” ShPK në monedhën USD, në Raiffeisen Bank, për periudhën 02.10.2009 - 27.01.2015, trupi gjykues vendosi të mos i marrë ato si provë pasi nuk plotësonin kërkesat e nenit 47 të ligjit nr. 49/2012, sikurse është arsyetuar më lart në këtë vendim.
112. Bazuar në sa më sipër, trupi gjykues e gjen të drejtë vlerësimin e Komisionit se: *subjekti i rivlerësimit dhe familja e tij kanë pasur mungesë të burimeve të ligjshme financiare, së paku në masën 3.750.154 lekë dhe, për sa kohë nuk janë deklaruar as kryerja e as burimet e përdorura për këto shpenzime, subjekti ka kryer deklarime të pamjaftueshme dhe të paplota në vitet përkatëse,*

⁴⁴ Referuar faqes nr. 35, poshtëshënimi nr. 61, në rezultatet e hetimit.

duke shmangur kontrollin e tyre nga organet kompetente dhe, si pasojë, subjekti i rivlerësimit rezulton me mungesë të burimeve financiare të ligjshme për justifikimin e tyre, duke u gjendur në kushtet e nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.

➤ Në lidhje me analizën financiare për periudhën 2003-2016:

113. Subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar si të gabuar vlerësimin e Komisionit se, nga analiza financiare për periudhën 2003-2016, *ka rezultuar një bilanc i përgjithshëm negativ në masën (-) 8.523.143 lekë, për të mbuluar të gjitha shpenzimet/pagesat dhe investimet e familjes së subjektit të rivlerësimit të deklaruar dhe/ose të konstatuara, siç është detajuar në tabelën që vijon, si dhe (-) 3.750.154 lekë për të mbuluar shpenzimet e jetesës dhe shkollimit të vajzës në ShBA.*
114. Këtë shkak ankimi, subjekti i rivlerësimit e ka bazuar në pretendimet se: (i) referuar analizës financiare të kryer nga audituesi ligjor i pavarur, i vetmi vit me balancë negative, është viti 2012, në shumën 256.079 lekë, e cila, referuar jurisprudencës së Komisionit dhe Kolegjit⁴⁵, duhet të interpretohet bazuar në parimin e proporcionalitetit; (ii) të ardhurat e fituara nga burime të ligjshme të subjektit të rivlerësimit dhe familjes së tij janë në shumën prej 22.008.925 lekësh, ndërkohë që pasuritë e krijuara për gjithë periudhën 2003-2016, janë në shumën 2.852.081 lekë, ose 12,96% e të ardhurave, shumë kjo e papërfillshme në raport me të ardhurat; (iii) Komisioni ka gabuar në përlllogaritjen e bërë në analizë financiare lidhur me: të ardhurat nga bursa e vajzës së saj në Greqi; shpenzimet e udhëtimit për vitet 2009 – 2013 të vajzës dhe ish-bashkëshortit të saj; të ardhurat nga qiradhënia e zyrës, për sa kohë referuar legjislacionit në fuqi, detyrimi për pagimin e tatimit në burim ka qenë i qiramarrësit; mospërfshirjen në kursimet e deklaruar të një depozite bankare të tërhequr në shumën 256.000 lekë, në Raiffeisen Bank, e investuar në vitin 2009; të ardhurat e ish-bashkëshortit nga punësimi në vitin 2011; shpenzimet e jetesës për vitin 2013, pasi ajo ka jetuar vetëm që prej vitit 2011 dhe për shumë vite shpenzimet kanë qenë minimale.
115. Lidhur me këtë shkak ankimi, trupi gjykues kontrolloi nëpërmjet Njesisë së Shërbimit Ligjor, analizën financiare të Komisionit për periudhën 2003-2016, duke mbajtur në konsideratë edhe analizën e bërë më sipër në këtë vendim, lidhur me burimet financiare të deklaruar nga subjekti për krijimin e pasurisë “zyrë”. Nga ky kontroll, trupi gjykues konstatoi dhe vlerësoi sa më poshtë.
116. Në lidhje me të ardhurat nga bursa e vajzës së subjektit të rivlerësimit në Greqi, në analizën e viteve 2008, 2009 dhe 2010, trupi gjykues i ka konsideruar ato si të ardhura të ligjshme në masën 600 euro në muaj dhe, për rrjedhojë, balanca negative e vitit 2008 reduktohet në shumën 591.730 lekë, ndërsa viti 2010 u përlllogarit me balancë pozitive.
117. Për përlllogaritjen e shpenzimeve të udhëtimit për periudhën 2009-2013, Komisioni, në vendim, ka arsyetuar se: *Lidhur me vitin 2009, Komisioni i ka vlerësuar bindëse shpjegimet e subjektit, për*

⁴⁵ Subjekti i rivlerësimit i referohet vendimit nr. 188, datë 24.07.2019, vendimit nr. 219, datë 10.12.2019, vendimit nr. 215, datë 04.12.2019, vendimit nr. 176, datë 08.07.2019, vendimit nr. 201, datë 25.10.2019, vendimit nr. 281, datë 27.07.2020, vendimit nr. 283, datë 29.07.2020, të Komisionit.

sa u përket shpenzimeve për kartonin jeshil për një periudhë 1-vjeçare, si dhe shpenzimet për udhëtimet ditore me destinacion Janinën, me 20 euro/dita në vend të 25 euro/dita, të përlllogaritura më herët. Nga shqyrtimi i udhëtimeve të vitit 2009, nuk ka rezultuar ndonjë udhëtim me autobus, por prej subjektit janë pretenduar udhëtimet pa automjet – më këmbë. Për sa kohë nuk është provuar dhe/ose nuk ka rezultuar kryerja e udhëtimeve me autobus, dhe duke u përjashtuar mundësia e një udhëtimi në këmbë/pa automjet, Komisioni i ka përlllogaritur shpenzimet përkatëse si udhëtime me automjet privat. Për më tepër që udhëtimi vajtje-ardhje me autobus kushton 15 euro, ndërkohë që shpenzimet e naftës me automjet janë 12-13 euro. Në përfundim, pasi janë marrë në konsideratë disa nga pretendimet e subjektit, shpenzimet e udhëtimeve ndryshojnë me një pakësim, nga 1.151.794 lekë në 1.069.355 lekë. Lidhur me vitin 2010, Komisioni ka pranuar pretendimin lidhur me shpenzimin e përlllogaritur për kartonin jeshil për një periudhë 1-vjeçare, si dhe shpenzimet për udhëtimet ditore me destinacion Janinën, me 20 euro/dita në vend të 25 euro/dita. Nga shqyrtimi i udhëtimeve të vitit 2010, nuk ka rezultuar ndonjë udhëtim me autobus, si dhe shpenzimi për vitin 2010 është 15 euro si me automjet dhe me autobus. Për pasojë e pranimit të këtyre pretendimeve mbi udhëtimet si më sipër, rezultati financiar i vitit 2010 ndryshon nga (-) 668.613 lekë në (-) 37.446 lekë. Lidhur me vitin 2011, Komisioni sërish ka hequr shpenzimin e përlllogaritur për kartonin jeshil për një periudhë 1-vjeçare, si dhe shpenzimet për udhëtimet ditore me destinacion Janinën dhe janë rillogaritur me kosto 20 euro/dita në vend të 25 euro/dita, që ishin përlllogaritur më herët. Për rrjedhojë e pranimit të këtyre pretendimeve, rezultati financiar i vitit 2011, ndryshon nga (-) 1.890.374 lekë në (-) 1.003.180 lekë. Për vitin 2012, Komisioni ka pranuar heqjen e koston 1-vjeçare për kartonin jeshil të siguracionit për jashtë shtetit, si dhe shpenzimet për udhëtimet ditore me destinacion Janinën janë përlllogaritur me 20 euro/dita në vend të 25 euro/dita. Lidhur me vitin 2013, Komisioni, gjithashtu ka pranuar pretendimet e subjektit mbi heqjen e koston 1-vjeçare për kartonin jeshil të siguracionit për jashtë shtetit, si dhe shpenzimet për udhëtimet ditore me destinacion Janinën janë përlllogaritur me 20 euro/dita në vend të 25 euro/dita [...] nga ripërlllogaritjet, ka rezultuar se bilanci i vitit 2013, ndonëse mbetet në vlerë negative, ndryshon nga (-) 497.035 lekë në (-) 353.428 lekë.

118. Subjekti i rivlerësimit, në lidhje me shpenzimet e udhëtimit për vitet 2009-2013, ka pretenduar se:
- (i) për vitin 2009 janë llogaritur 1.151.794 lekë, ndërkohë që duhet të llogariteshin në shumën 928.481 lekë, duke konsideruar se, për udhëtimet brenda ditës me destinacion Janinën, kostoja është 20 euro/dita në vend të 25 euro/dita. Kartoni jeshil duhet konsideruar si njëvjeçar dhe jo 2-javor, duke qenë se udhëtimet janë të shpeshta, si dhe duhet të sistemohen shpenzimet e transportit për udhëtimet me autobus në shumën 15 euro vajtje-ardhje në vend të shpenzimeve të naftës;
 - (ii) për vitin 2010, shpenzimet e udhëtimit të llogaritura në shumën 1.062.217 lekë, duhet të llogariten në total në shumën 406.340 lekë për të njëjtat arsye;
 - (iii) për vitin 2011, shpenzimet e udhëtimit nga 1.549.237 lekë duhet të llogariten në total në shumën 600.823 lekë;
 - (iv) për vitin 2012, shpenzimet e udhëtimit nga 1.214.671 lekë duhet të llogariten në total në shumën 955.769 lekë;
 - (v) për vitin 2013, shpenzimet e udhëtimit nga 514.455 lekë duhet të llogariten në shumën 384.901 lekë.

119. Referuar sa më sipër, si dhe nga verifikimi nëpërmjet Njesisë së Shërbimit Ligjor i përlllogaritjeve të kryera nga Komisioni në raport me pretendimet e subjektit të rivlerësimit në lidhje me shpenzimet e udhëtimit për periudhën 2009-2013, trupi gjykues konstaton se pretendimet kryesore të subjektit në lidhje me këto shpenzime, janë reflektuar në analizën financiare të kryer nga Komisioni⁴⁶, për rrjedhojë ato vlerësohen të pabazuara.
120. Në lidhje me pretendimin e subjektit se për tri udhëtime të ish-bashkëshortit të saj, të cilat janë përlllogaritur me 66 ditë, 12 ditë dhe 12 ditë nga Komisioni, duhet të përlllogariten me qëndrim përkatësisht vetëm 3 ditë dhe nga 2 ditë për çdo udhëtim, pasi nuk mund të penalizohet subjekti për mungesën e të dhënave në sistemin TIMS, nga verifikimi i përlllogaritjeve të kryera nga Komisioni, trupi gjykues konstaton se këto udhëtime të kryera nga ish-bashkëshorti, i përkasin vitit 2010 (konkretisht datës 15.07.2010, datës 13.10.2010, si dhe datës 29.10.2010) dhe rezultojnë të jenë përlllogaritur nga Komisioni sipas pretendimit të subjektit, për rrjedhojë pretendimi i subjektit në lidhje me këto udhëtime, nuk qëndron.
121. Në lidhje me pretendimin e subjektit se për 4 udhëtime të vajzës dhe të bashkëshortit të saj në vitin 2011, të llogaritura me 14 ditë, 8 ditë, 54 ditë dhe 55 ditë qëndrimi nga Komisioni, duhen përlllogaritur me 1 ditë qëndrimi, pasi nuk mund të penalizohet subjekti për mungesën e të dhënave në sistemin TIMS, trupi gjykues, pas verifikimit të përlllogaritjeve të kryera nga Komisioni, konstaton se, për 3 nga këto udhëtime⁴⁷, shpenzimet janë përlllogaritur 50 euro (pra, kosto për 1 ditë qëndrimi), për rrjedhojë edhe ky pretendim i subjektit nuk qëndron. Sa i takon udhëtimit të datës 21.11.2011 - 15.01.2012 (55 ditë) të kryer nga M. K., për të cilin subjekti i rivlerësimit pretendon se Komisioni ka llogaritur kosto qëndrimi në shumën 275 euro, trupi gjykues, pas verifikimit nëpërmjet Njesisë së Shërbimit Ligjor, konstaton se shpenzimi 275 euro është llogaritur drejt nga Komisioni me kosto 5 euro dita për 55 ditët e qëndrimit të afërmit, për rrjedhojë pretendimi i subjektit nuk qëndron.
122. Lidhur me pretendimin e subjektit për përfshirjen në analizë financiare të ardhurave nga qiradhënia e zyrës, për sa kohë, referuar legjislacionit në fuqi, detyrimi për pagimin e tatimit në burim ka qenë i qiramarrësit, trupi gjykues në vijim të analizës që ka bërë për këto të ardhura më sipër në

⁴⁶ Komisioni ka pranuar si pretendimet e subjektit për sa u përket shpenzimeve për kartonin jeshil, ashtu edhe për shpenzimet për udhëtimet brenda ditës me destinacion Janinën, në shumën 20 euro/dita. Për udhëtimet vajtje-ardhje me autobus, kostoja e udhëtimit e përlllogaritur nga Komisioni është në shumën 12 -13 euro për vitin 2009, pra më pak nga sa pretendon subjekti. Për vitin 2010, ka përlllogaritur shumën 15 euro, si kosto të njëjtë si udhëtimet e kryera me autobus, ashtu edhe ato të kryera me automjet. Për vitin 2011, Komisioni ka përlllogaritur koston e transportit në shumën 16 - 17 euro (sipas koston së karburantit gjatë vitit 2011), aq sa subjekti ka pretenduar në raportin e auditit (faqe nr. 23). Për vitin 2012, Komisioni ka përlllogaritur koston e transportit në shumën 19 euro, aq sa subjekti ka pretenduar në raportin e auditit (faqe nr. 27). Sa i takon vitit 2013, Komisioni ka përlllogaritur koston e transportit në shumën 18 euro, aq sa subjekti ka pretenduar në raportin e auditit (faqe nr. 30).

⁴⁷Përkatësisht udhëtimi i datës 05.02.2011 - 19.02.2011 (14 ditë), i kryer nga J. K., udhëtimi i datës 13.03.2011 - 20.03.2011 (8 ditë) dhe udhëtimi i datës 19.09.2011 - 12.11.2011 (54 ditë), të kryer nga M. K..

këtë vendim, si një nga burimet financiare për krijimin e pasurisë “zyrë”, konstaton dhe vlerëson si më poshtë.

123. Komisioni, në kuadër të analizës së ligjshmërisë së të ardhurave të deklaruara si të krijuara nga dhënia me qira e pasurisë “zyrë”, në pikën nr. 42 të vendimit ka arsyetuar se: [...] *Komisioni ka konsideruar si të ardhura me burim të ligjshëm nga qiradhënia ato të periudhës mars 2008 – qershor 2009 dhe të viteve 2015 e 2016, për të cilat është provuar pagesa e detyrimeve tatimore përkatëse. Për periudhat e tjera midis – prej të cilave disa nuk kanë rezultuar të mbuluara me një kontratë qiraje, por dhe ato të mbuluara me një të tillë, ku është specifikuar në kontratë se detyrimin për pagimin e tatimit në burim e ka qiramarrësi – për sa kohë në llogarinë e subjektit të rivlerësimit apo ish-bashkëshortit janë transferuar shumat bruto të qirasë prej 30.000 lekësh/muaj (ndryshe nga çka ndodhur nga qershori i vitit 2017 e në vijim, ku në llogarinë e subjektit është transferuar shuma neto e qirasë, pas mbajtjes së tatimit në burim) dhe nuk është mbajtur në burim tatimi mbi këto të ardhura – Komisioni nuk i ka konsideruar në analizën financiare si të ardhura me burim të ligjshëm, në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.*
124. Komisioni në pikën 51 të vendimit ka arsyetuar se: *lidhur me të ardhurat e pretenduara nga qiradhënia e njësisë zyrë, për të cilat subjekti i rivlerësimit ka paguar detyrimet tatimore për vitin 2010, pas marrjes së rezultateve të hetimit, duke iu referuar edhe jurisprudencës dhe orientimeve të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit – sipas të cilave, pagesa e detyrimeve tatimore pas dorëzimit të deklaratës vetting nuk mund të zhbëjë qasjen e subjekteve në kundërshtim me ligjin ndër vite, të karakterizuar pikërisht nga mospagimi i detyrimeve tatimore në momentin dhe vitin përkatës – çmon se këto të ardhura nuk mund të konsiderohen dhe të përlllogariten si të ligjshme, në kuptimin e nenit D të Aneksit të Kushtetutës, për sa kohë për këto të ardhura nuk janë paguar tatimet kur ato janë realizuar, por përgjatë procesit të rivlerësimit, ndërkohë që detyrimet tatimore përkatëse duhet të ishin shlyer sipas parashikimeve të dispozitave ligjore përkatëse, shumë vite më herët.*
125. Subjekti i rivlerësimit e kundërshton këtë vlerësim të Komisionit, me pretendimin se Komisioni ka gabuar në vlerësimin si të paligjshme të një pjese të të ardhurave të krijuara nga qiradhënia pasi në rastin kur qiramarrësi është subjekt juridik (në këtë rast, subjekti politik {***}), ligji ngarkon atë me mbajtjen në burim të tatimit mbi të ardhurat nga qiraja në cilësinë e agjentit tatimor.
126. Rezultoi se subjekti i rivlerësimit, duke filluar nga viti 2008 e në vijim, ka deklaruar në deklaratat periodike vjetore dhënien me qira të njësisë “zyrë”, kundrejt vlerës prej 30.000 lekësh në muaj. Për të provuar sa më sipër, bashkëngjitur deklaratës vetting, subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar kontratën nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 04.03.2008, të nënshkruar nga ish-bashkëshorti i saj në cilësinë e qiradhënësit dhe subjektit politik {***}, Dega Gjirokastër, si dhe kontratën nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 14.05.2014, të nënshkruar ndërmjet subjektit të rivlerësimit dhe shtetasit A. M., përfaqësues i subjektit politik {***}, Dega Gjirokastër. Gjatë hetimit administrativ, nëpërmjet pyetësorit nr. 2, Komisioni i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit që të paraqesë të gjitha kontratat e qirasë të nënshkruara mes palëve, përgjatë periudhës 2008 e në vijim. Në përgjigje, subjekti ka shpjeguar se: *Kontratat e qirasë nuk janë rinovuar me shkrim në përfundim të secilës*

kontratë, por janë zgjatur në heshtje dhe në komunikim gojarisht midis palëve. Në fakt, që ditën e firmosjes së kontratës së parë, në datën 04.03.2008, dhe deri më sot kjo zyrë ka qenë me qira nga subjekti politik {***}, Dega Gjirokastër. Në rastin konkret, zyra ka qenë gjithë kohës në përdorim të subjektit politik {***}, gjë që deklarohej dhe nga qiramarrësi. Pra, në një periudhë të ndërmjetme, kontrata ka vazhduar në heshtje, por pa ndërprerje midis të njëjtave palë. Në mbështetje të sa më sipër, subjekti ka paraqitur deklaratën me vërtetim nënshkrimi nr. {***} rep., datë 09.03.2021, nga noter E. P. A., nënshkruar nga V. T. dhe A. L., të cilët kanë deklaruar se, me subjektin e rivlerësimit dhe ish-bashkëshortin e saj kanë lidhur kontratë qiraje për njësinë “zyrë” në lagjen “{***}”, Gjirokastër, prej vitit 2008 e në vazhdim pa ndërprerje. Po ashtu, subjekti ka paraqitur një kontratë qiraje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 23.05.2012, të lidhur midis ish-bashkëshortit të saj dhe shtetasit G. S., si përfaqësues i subjektit politik {***}, si dhe një kontratë qiraje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 01.06.2017, të lidhur me subjektin politik {***}, për dhënien e ambientit “zyrë” me qira. E pyetur nga Komisioni në lidhje me pagesën e detyrimeve tatimore, në përgjigje të pyetësorit nr. 1, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se detyrimet tatimore janë paguar sipas kontratave respektivisht nga palët. Në vijim të këtij deklarimi, Komisioni i ka kërkuar subjektit, nëpërmjet pyetësorit nr. 2, të paraqesë dokumentacionin ligjor për të provuar pagimin e detyrimeve tatimore përgjatë të gjithë periudhës. Në përgjigje të sa më sipër, subjekti ka paraqitur një deklaratë të datës 21.08.2009, nga subjekti politik {***}, Dega Gjirokastër, në të cilën deklarohej se për periudhën 01.03.2008 deri në 30.06.2009, janë kryer të gjitha pagesat për qiranë, energjinë elektrike, ujin dhe tatimin mbi qiranë e zyrës, si dhe ka bashkëngjitur edhe një mandatar-këtimin pranë Raiffeisen Bank, të datës 20.08.2009, me përshkrimin “tatim qiraje mars 2008 – 30 qershor 2009 për J. K.”, veprim ky i nënshkruar nga përfaqësuesi i subjektit politik {***}, G. S.. Lidhur me pagesat tatimore për vitet e tjera, subjekti ka paraqitur një vërtetim nr. {***} prot., datë 18.02.2020, të lëshuar nga DRT, Tiranë, e cila ka bërë me dije se subjekti politik {***} ka paguar në total për zërin “tatim në burim (qira)” vlerën prej 13.458.893 lekësh për periudhën dhjetor 2014 e në vijim, ku nuk individualizohet emri i subjektit, pasi nga ana e tatimpaguesit nuk ka dokumentacion të dorëzuar, ku të jetë deklaruar se për kë individ janë kryer pagesat. Në lidhje me sa më sipër, subjekti ka shpjeguar se: *Duke u interesuar pranë DPT, më sqaruan se para periudhës dhjetor 2014, nuk ekzistonte deklaratë elektronike për tatimin në burim dhe, për pasojë, nuk mund të më jepet informacion. Për periudhën para dhjetor 2014, pagesat bëheshin vetëm me një përshkrim nga tatimpaguesi pranë bankës. Gjithashtu, më sqaruan se pagesat e kryera nga ana e {***}-së, për periudhën dhjetor 2014 (kryer më 26.09.2015) dhe për periudhën shtator 2015 (kryer më 06.10.2015), janë shuma të mëdha (1.536.565 lekë dhe 1.481.049 lekë) dhe janë pagesa për detyrime të prapambetura nga periudhat e mëparshme. Dua të sqaroj se shuma e tatimit në burim për periudhën 2008-2016, që duhej të derdhej nga subjekti {***}, rezulton të jetë derdhur, pasi shuma totale e tatimit është 397.059 lekë. Për vitet 2015 dhe 2016⁴⁸, rezulton se tatimi është paguar nga vetë subjekti i rivlerësimit, për shkak se nga ana e*

⁴⁸ Subjekti i ka bashkëngjitur deklaratës vetting, DIVA të viteve 2015 dhe 2016, të dorëzuara në datë 24.01.2017, në të cilat janë deklaruar të ardhurat nga qiradhënia për këto dy vite, si dhe mandatet e pagesave të kryera për tatimin

subjektit politik {***}, nuk u vunë në dispozicion pagesat përkatëse. Pas rezultateve të hetimit, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur një urdhërshirimi të datës 25.06.2021 të OTP Bank, ku përshkruhet pagesa për tatim qiraje për zyrën, për vitin 2010 dhe 2011, në vlerën 72.000 lekë.

127. Nga analizimi i kuadrit ligjor të kohës lidhur me tatimin mbi të ardhurat personale, trupi gjykues konstatoi se në nenin 8, pika 1, germa “dh” e ligjit nr. 8438 “Për tatimin mbi të ardhurat personale”, i ndryshuar, përcaktohet se për qëllime të tatimit mbi të ardhurat personale, merren si të ardhura të tatueshme edhe të ardhurat nga qiraja, ndërsa sipas nenit 33, pika 1, germa “ë” e këtij ligji dhe pikës 5.1 të udhëzimit nr. 5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të gjithë personat, përfshirë personat juridikë, ortakëritë, personat fizikë tregtarë rezidentë tatimorë në Republikën e Shqipërisë, organet e qeverisjes qendrore e vendore, organizatat jofitimprurëse dhe çdo ent apo person juridik i krijuar si i tillë në Shqipëri, që bën pagesë të çdonjërës nga llojet e pagesave që listohen në nenin 33, është i detyruar të mbajë tatim në burim dhe ta derdhë atë në organin tatimor përkatës jo më vonë se data 20 e muajit që pason muajin në të cilin është kryer pagesa.
128. Në analizë të sa më sipër konstatuar, vlerësohet se, pavarësisht se referuar përmbajtjes së kontratave të lidhura për dhënien me qira të kësaj pasurie, nuk përcaktohet gjithnjë detyrimi për pagesën e tatimit mbi të ardhurat e përfituara nga qiraja, parashikimi ligjor është i qartë se në rastin kur qiramarrësi është person juridik, ai ka detyrimin ligjor të mbajë në burim dhe të paguajë detyrimin si agjent tatimor në afatin e caktuar me ligj. Duke pasur parasysh se subjekti i rivlerësimit i ka deklaruar rregullisht në deklaratat periodike të ardhurat e përfituara nga dhënia me qira e kësaj pasurie duke filluar që nga viti 2008, dhe një pjesë e tyre janë të dokumentuara me dokumentacion bankar, trupi gjykues çmon se, pavarësisht problematikave në përmbajtjen dhe ekzekutimin e kontratave, apo parregullsive nga ana e qiramarrësit në lidhje me pagesat e detyrimeve tatimore apo dokumentimin e tyre, subjekti i rivlerësimit ka përfutur të ardhura të ligjshme nga qiraja, të cilat do të duhet të përfshihen në analizën financiare të kryer nga Komisioni, në masën e deklaruar në deklaratat periodike vjetore.
129. Në lidhje me pretendimin e subjektit se Komisioni nuk ka pasqyruar në analizë depozitën bankare në shumën 256.000 lekë, e cila është investuar në vitin 2009, nga verifikimi i akteve në fashikullin e Komisionit, trupi gjykues vëren se depozita bankare pranë Raiffeisen Bank, me gjendje likuiditeti në shumën 256.536 lekë në datën 31.12.2009, rezulton në emër të babait të subjektit J. M. I. dhe nuk konsiderohet e ardhur e subjektit të rivlerësimit, për rrjedhojë, Komisioni me të drejtë nuk e ka përlllogaritur këtë depozitë në analizën financiare të këtij viti.
130. Në lidhje me pretendimin e subjektit për përfshirjen në analizë financiare të të ardhurave nga paga në shoqërinë “{****}” ShPK, rezulton se në DIPP-2011, subjekti ka deklaruar: *Të ardhura të bashkëshortit, paga mujore në vlerën 40.000 lekë në muaj*. Në ankim, subjekti ka pohuar se ish-bashkëshorti nuk ka rezultuar i siguruar përgjatë vitit 2011. Në këto kushte, këto të ardhura nuk

e qirasë për këto dy vite nëpërmjet Societe Generale Bank Albania (sot OTP Bank), të kryera po në datë 24.01.2017, përpara dorëzimit të deklaratës vetting.

plotësojnë standardin e së ardhurës financiare të ligjshme në kuptim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe, si rrjedhojë, trupi gjykues e gjen të drejtë qëndrimin e Komisionit.

131. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se shpenzimet e jetesës për vitin 2013, duhet të përlllogariten vetëm për një person, pasi vajza e saj ka jetuar në ShBA dhe po atë vit *de facto* ajo është ndarë nga ish-bashkëshorti, trupi gjykues konstaton se për vitin 2013, Komisioni i ka përlllogaritur shpenzimet e jetesës për ish-bashkëshortin për 9 muaj, ndërsa për vajzën për 3 muaj qëndrimi në Shqipëri⁴⁹, sipas të dhënave nga sistemi TIMS. Trupi gjykues, nga verifikimi i dokumentacionit të administruar gjatë procesit në Komision, konstaton se zgjidhja e martesës së subjektit është bërë me vendim të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër nr. {***}, datë 23.09.2013, dhe duket se Komisioni, bazuar në këtë vendim, ka përlllogaritur 9 muaj shpenzime jetese për ish-bashkëshortin e saj. Sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se referenca që i bën Komisioni kësaj date, në mungesë të një date tjetër nëpërmjet së cilës të faktohet zgjidhja *de facto* e kësaj martese, konsiderohet një qëndrim i drejtë, në përputhje me të dhënat që burojnë nga provat në fashikull. Pavarësisht sa më sipër, duke vlerësuar të besueshëm pretendimin e subjektit të rivlerësimit se ish-bashkëshorti i saj nuk ka jetuar me subjektin para zgjidhjes së martesës në vitin 2013, si një moment jetësor i cili, ndër të tjera, karakterizohet pikërisht nga mungesa e jetesës së përbashkët të bashkëshortëve, trupi gjykues vlerëson se në analizën financiare për këtë vit, duhet të përfshihen shpenzimet e jetesës vetëm për subjektin e rivlerësimit dhe vajzën e saj, në përputhje me kohën e qëndrimit të saj në Shqipëri. Në konsideratë të sa më sipër, trupi gjykues vlerëson po ashtu se në analizën financiare të subjektit të rivlerësimit, nuk duhet të përfshihen edhe shpenzimet e udhëtimeve të kryera në vitin 2013 nga ish-bashkëshorti i saj, të përlllogaritura nga Komisioni në shumën 909 euro, duke sjellë si efekt ulje të shpenzimeve të udhëtimit për këtë vit.
132. Fakti që vlerësimi i provave nga Komisioni, lidhur me analizën financiare, është i ndryshëm nga pritshmëritë dhe pretendimet e subjektit të bazuara edhe aktin e audituesit ligjor të caktuar prej saj, nuk nënkupton se ato nuk janë vlerësuar nga Komisioni sipas kompetencave të parashikuara në Aneksin e Kushtetutës dhe ligjin nr. 84/2016 dhe, për këtë arsye, pretendimi i subjektit të rivlerësimit për moskonsiderimin e tyre nga Komisioni, vlerësohet i pabazuar.
133. Në përfundim të analizës së shkakut të ankimit, lidhur me analizën financiare për periudhën 2003-2016, trupi gjykues vlerësoi se subjekti i rivlerësimit ka pasur mungesë të burimeve financiare të ligjshme për vitin 2006 në shumën (-) 585.429 lekë, për vitin 2008 në shumën (-) 591.730 lekë, për vitin 2011 në shumën (-) 643.180 lekë, për vitin 2012 në shumën (-) 659.727 lekë, për vitin 2014 në shumën (-) 3.929.003 lekë, dhe në total në shumën (-) 6.409.069 lekë për krijimin e pasurive dhe përbalimin e shpenzimeve, duke u gjendur në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

⁴⁹Referuar të dhënave nga sistemi TIMS, rezulton se vajza e subjektit ka dalë nga pika kufitare e Rinasit me destinacion New Jersey në datën 08.09.2012 dhe ka hyrë në Shqipëri në datën 06.07.2013. Më tej, rezulton se ajo ka përsëri dalje nga Rinasia në datën 05.09.2013 dhe ka hyrë në Shqipëri në datën 27.11.2013, për rrjedhojë rezulton se vajza për 9 muaj, përgjatë vitit 2013, nuk ka jetuar në Shqipëri.

134. Po ashtu, subjekti i rivlerësimit rezultoi me mungesë të burimeve financiare të ligjshme, së paku në vlerën (-) 3.750.154 lekë, për të mbuluar shpenzimet e shkollimit dhe jetesës së personit të lidhur (vajzës) në ShBA, duke u gjendur në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.
135. Bazuar në konkluzionet e mësipërme, trupi gjykues i Kolegjit arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit rezulton se ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e vlerësimit të pasurisë, duke u gjendur në kushtet e nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016 dhe nenit D, pikat 1, 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës. Për pasojë, vendimi nr. 420, datë 13.07.2021, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit është i mbështetur në fakte dhe në ligj dhe, si i tillë, duhet të lihet në fuqi.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues i Kolegjit, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 420, datë 13.07.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Mirela Iliopullo.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, në Tiranë, më datë 05.12.2024.

ANËTARE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

ANËTARE

Ina RAMA

nënshkrimi

ANËTARE

Mimoza Tasi

nënshkrimi

RELATOR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

KRYESUESE

Natasha MULAJ

nënshkrimi